



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2025 mori këtë:

V E N D I M **PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR MEMORIALIN KUSHTUAR ARTISTIT** **‘FARUK BEGOLLI’**

- I. MIRATOHET** Vendimi për caktimin e lokacionit për Memorialin kushtuar artistit të mirënjohur “Faruk Begolli”. Artisti në fjalë përpos trashëgimisë së madhe që la pas në fushën e artit skenik, njëherit është edhe një nga themeluesit e Fakultetit të Artit Dramatik pranë Universitetit të Prishtinës.
- II.** Lokacioni për vendosjen e gjendet në kuadër të parcelës kadastrale me nr. 10297-0 ZK Prishtinë, në pronësi - Pronë Shoqërore në afërsi të ndërtesës së Ministrisë së Kulturës në Bulevardin “Nëna Terezë”.
- III.** Ky vendim paraqet bazë për caktimin e lokacionit ku do të organizohet konkurs artistik dhe arkitektonik për vendosjen e lapidarit/shtatores përkujtimore.
- IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Kopja e planit, Fleta poseduese, Pamje nga Google Earth, dhe ortofoto e lokacionit.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Kadastrit dhe drejtoritë e tjera kompetente të Kryeqytetit.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina

A R S Y E T I M

I Vendimit për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit “ Faruk Begolli”

Drejtoria e Planifikimit Strategjik, ka shqyrtuar kërkesën për caktimin e lokacionit për memorialin/shtatoren e artistit “Faruk Begolli”. Kjo kërkesë është adresuar edhe në Kuvendin e Kryeqytetit dhe është mbështetur edhe nga Kryetari i Kryeqytetit.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik, sipas kërkesës së lartë cekur dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie ka identifikuar lokacionin për memorialin/shtatoren e artistit “Faruk Begolli”. Lokacioni i propozuar shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. parcelës kadastrale me nr. 10297-0 ZK Prishtine, në pronësi - Pronë Shoqërore, në afërsi të ndërtesës së Ministrisë së Kulturës në Bulevardin “Nëna Terezë”.

Meqenëse hapësira e cila parashihet për Memorialin në fjalë, momentalisht është hapësirë e gjelbër në shërbim të bllokut, memoriali duhet të jetë në me qasje miqësore ndaj ambientit si për nga përdorimi i materialeve ashtu edhe për nga madhësia, forma dhe pozicionimi. Duke marrë parasysh këtë si dhe rëndësinë historike të artistit të cilit i kushtohet memoriali, pas përcaktimit të lokacionit përzgjedhja e projektit për realizim do të bëhet përmes konkursit të hapur për dizajnimin e tij.

Bashkangjitur:

Fleta poseduese

Kopja e planit

Pamje nga Google Earth

Ortofo e lokacionit.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71914059-10297-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	11-942/03-0023254/25
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	13.02.2025 - 11:15
Komuna / Opština / Municipality:	PRISHTINË / PRIŠTINA / PRISHTINE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Prishtinë / Priština / Prishtine
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	PRISHTINË / PRIŠTINA / PRISHTINE

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71914059-10297-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	6760	1-1996, R.F.P.284/2019	26.12.2019	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
BUL. NËNA TEREZË				



Fleta poseduese




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRISHTINË
 Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prishtinë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71914059-10297-0	Parcelë / Parcela / Parcel	6760



Shkalla/Razmera/Scale: 1:907




Punoi/Obradio/Created: Drenusha Shala

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beteška/Note:

Data/ Data/Date: 13.02.2025

Koha/ Vreme/ Time: 11:16:53



Pamje nga Google Earth



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.1.2025, mori këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E MEMORIALIT KUSHTUAR DËSHMORËVE HYZRI TALLA, AFRIM MALIQI DHE ILIR DURMISHI

- I. MIRATOHET** Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Memorialit kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi, të vrarë me 2 dhjetor 1998, nga një pritë e organizuar nga shërbimi serb afër Qendrës së Studentëve në Prishtinë.
- II.** Lokacioni për vendosjen e Memorialit gjendet ne kuadër të parcelës kadastrale, nr. 10015-0, ZK Prishtinë, në pronësi - pronë shoqërore, KK Prishtinë, në lagjen “Bregu i Diellit”, në afërsi të Qendrës Tregtare, saktësisht në vendin ku gjendet lapidari ekzistues.
- III.** Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së memorialit përkujtimor.
- IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Certifikata e pronësisë, incizimi nga Google Earth, dhe ortofoto e lokacionit, kopja e planit.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Kadastrit, si dhe drejtoritë tjera kompetente të Kryeqytetit.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

A R S Y E T I M

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e memorialit kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi

Drejtorja e Planifikimit Strategjik, ka shqyrtuar kërkesën, nr. 04-353/01-114614/24, të dt. 30.8.2024 nga Hyzri Durmishi, familjar i dëshmorëve, për caktimin e lokacionit për vendosjen e Memorialit kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi, të vrarë me 2 dhjetor 1998, nga një pritë e organizuar nga shërbimi serb, afër Qendrës së Studentë në Prishtinë, derisa ndodheshin në një mision ushtarak për çlirimin e Kosovës.

Kjo kërkesë është adresuar edhe në Kuvendin e Kryeqyteti dhe është mbështetur edhe nga Kryetari i Kryeqytetit.

Drejtorja e Planifikimit Strategjik, sipas kërkesës së lartcekur dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin për Memorialin kushtuar rënies heroike të dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban, të miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 035-181427, dt. 24.9.2013, sipas të cilit kjo zonë është brenda bllokut me ndërtim të lartë.

Lokacioni i propozuar shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale, nr. 10015-0, ZK e Prishtinë - pronë e Komunës së Prishtinë.

Meqenëse hapësira e cila parashihet për Memorialin në fjalë, tash për tash është hapësirë e gjelbër në shërbim të bllokut, memoriali duhet të jetë me qasje miqësore ndaj ambientit, si për nga përdorimi i materialeve, ashtu edhe për nga madhësia, forma dhe pozicionimi. Duke marrë parasysh këtë, si dhe rëndësinë historike të dëshmorëve të cilëve u kushtohet memoriali, pas përcaktimit të lokacionit përzgjedhja e projektit për realizim do të bëhet përmes konkursit të hapur për dizajnimin e tij.

Bashkëngjitur:


Dëshmia e pronësisë;

Kopja e planit;

Pamje nga Google Earth

Ortofoto e lokacionit.

Deshemia e pronësisë



Pamje nga Google Earth



Ortofoto e lokacionit- <http://geoportal.rks-gov.net/>



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17, shkronja b), nenit 40, shkronja l), të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje lokale, nenit 10, paragrafi 2.1 dhe nenit 17 paragrafi 1 të ligjit 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Udhëzimit administrativ MMPH-Nr. 01/18 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të hollësishme dhe Udhëzimit administrativ MMPH- Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe të nenit 15, paragrafi 15.1. shkronja b), nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja b) dhe nenit 34 paragrafi 34.1 shkronja d) Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë

V E N D I M

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM **“ÇAGLLAVICË” NË PRISHTINË**

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm “Çagllavicë” në Prishtinë.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, si çështje e përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me miratimin e Planit rregullues të hollësishëm nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe me mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4

Kufiri i territorit

Territori i Planit rregullues të hollësishëm për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm "Çagllavicë" në Prishtinë, përfshin sipërfaqe prej $S= 77.7$ ha.

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit është Drejtoria e Planifikimit e Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor, janë të siguruara nga buxheti i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartoj në afat për 6 - muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

Para finalizimit, Vendimi për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm, do të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Propozimplanit rregullues të hollësishëm në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve, do të shpallen përmes njoftimeve publike, konform nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, ku shqyrtimi publik do të zgjatë 15 ditë.

Neni 9
Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë 8 - vjeçare.

Neni 10
Gjuha Zyrtare

Plani rregullues i hollësishëm sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të originalit .

Neni 11
Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 3 e Ligjit për Planifikim hapësinor nr. 04/L-174.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit ne Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

A R S Y E T I M

i Vendimit për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm “Çagllavicë” në Prishtinë.

Hyrje

Duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 04/L-174, dhe duke u bazuar në kërkesën e qytetarëve për të investuar në këtë zonë, Komuna e Prishtinës do të formojë grupin punues me përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoritë tjera përgjegjëse, për analizë të zonës në fjalë, për inicim të procesit të **hartimit të Planit rregullues të hollësishëm “Çagllavicë” në Prishtinë.**

Inicimi i tillë është bërë bazuar edhe në komunikimet paraprake me MMPH-në, përkatësisht në përgjigjen e MMPH-së, nr. 4724/18, të dt. 21.9.2018, ku thuhet se komuna mund të hartojë plane rregulluese të hollësishme (rasti “Dodona”, blloku “A-1”), pasi që Udhëzimi administrativ i MMPH-së, nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, ka hyrë në fuqi, më 14.2.2018, dhe se Komuna duhet të bazohet në dokumentin e planifikimit hapësinor, Planin zhvillimor komunal të Komunës në fuqi, dhe sipas Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor (neni 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe nën paragrafi 1.6. të Ligjit).

Fushëveprimi

Plani Rregullues i hollësishëm do të përcaktojë kushtet ndërtimore sipas ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174, Udhëzimi administrativ MMPH-Nr. 01/18 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve rregulluese të hollësishme dhe Udhëzimit administrativ MMPH- Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Qëllimi

Kjo zonë ka mbetur jashtë trajtimit të çdo plani rregullues urban aktual, si dhe është jashtë kufirit të zonës urbane në Planin Zhvillimor Komunal të qytetit të Prishtinës. Duke pasur parasysh trendin e zhvillimit të qytetit gjatë viteve të fundit në këtë zonë, është e qartë se drejtimi i zhvillimit të qytetit po shkon drejt këtyre parcelave. Duhet theksuar se të gjitha parcelat fqinjë, deri në kufirin e kësaj zone, janë tashmë të zhvilluara dhe përfshihen në pjesë të rëndësishme të qytetit. Ky aks rrugor i rëndësishëm që lidhë qytetin e Prishtinës me Ferizajn dhe më tej me Shkupin, përveç se paraqet mundësi të jashtëzakonshme për zgjerimin e qytetit, gjithashtu ofron mundësi ideale për lehtësimin e trafikut, duke shkarkuar qendrën e qytetit nga dendësia e madhe e banorëve dhe aktivitetëve të ndryshme komerciale, edukative, sportive, shëndetësore dhe kulturore. Për shkak të fokusit të zhvillimit ekonomik përgjatë aksit të rrugës, zhvillimi urban i zonës stimulon zhvillimin e sektorëve të rinj ekonomik, si qendra për teknologji, tregti dhe hoteleri, funksione të cilat mund ta transformojnë Çagllavicën në një qendër të rëndësishme ekonomike. Duke pasur parasysh se këto parcela mbulojnë një sipërfaqe prej 77.7- hektarësh, propozojmë që këto të përdoren për zhvillime që do të krijonin mundësi për vendosjen e institucioneve të nevojshme për zonën dhe për zonat përreth. Në këtë sipërfaqe mund të propozohen parqe të mirëfillta, institucione parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme, objekte sportive e rekreative, qendra kulturore, stacion

poligor, fasilitete për zjarrfikësit, si dhe një infrastrukturë të mirëfilltë rrugore me standarde evropiane.

Plani do të adresoj çështje me qëllim të orientimit të investimeve publike dhe private, rigjallërimin e zonës, zhvillimin ekonomik, çështjet mjedisore.

Komuna e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm "Çagllavicë" në Prishtinë, i cili plan do të inkorporohet më pastaj në Hartën Zonale të Komunës së Prishtinës.

Ky plan do të mbuloj një periudhë së paku 8- vjeçare dhe ndryshimi i tij do të bëhet sipas Legjislacionit në fuqi.

Kufiri i Sipërfaqes së planifikuar


Zona për të cilën do të hartohet Planit rregullues të hollësishëm përfshin sipërfaqe prej $S= 77.7$ ha. Revidimi i Planit rregullues të hollësishëm do të caktojë kushtet ndërtimore sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 04/L-174 , UA MMPH 08/2017, për normat teknike për planifikim hapësinor dhe UA MMPH 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme.

Projektplani rregullues i hollësishëm para finalizimit, duke u bazuar në nenin 7, pika 2, të Udhëzimit administrativ për përgjegjësitë e autoritetit të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor nr. 05/2014, dhe sipas nenit 8, pika 4 të këtij udhëzimi.

Komuna do të publikojë draftin në dispozicion të publikut, grupeve të interesit, departamenteve dhe agjencive të tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim, dhe kjo periudhë do të zgjatë 15 ditë.

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik, duke u bazuar në nenin 11, pika 1.6.1 e Ligjit nr. 04/L-174, do ta menaxhon procesin e hartimit të planit përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda Komunës.

1. Kufiri i planit në raport me qytetin:



2. Kufiri i zonës që do të trajtohet:





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më __.__.____, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE
SHOQATËS "YJET QË NUK VDESIN"

1. MIRATOHET ndarja e mjeteve financiare shoqatës "Yjet që nuk vdesin", për realizimin e shfaqjes "*Pas luftës, kush jemi ne ?!*" për nder të Epopesë së UÇK-së.
2. Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është 20,000.00 € (njëzet mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transferove - Administrata 16306.
3. Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për realizimin e shfaqjes Dans-Teatër "*Pas luftës, kush jemi ne ?!*" për nder të Epopesë së UÇK-së.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kërkesa me dokumentacionin përcjellës të shoqatës "Yjet që nuk vdesin".
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtorja e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



KËRKESË

KOMUNËS SË PRISHTINËS

Z.PËRPARIM RAMA - Kryetar

Për mbështetje financiare të realizimit të projektit artistik

“Pas luftës, kush jemi ne?!”

Për nderë të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

SHOQATA

“YJET QË NUK VDESIN”

Prezanton

Shfaqjen Dans Teatër

“Pas luftës, kush jem ne?!”

Nga Robert Nuha

Ideator dhe Producent: **Prof. dr. Nusret Pllana**

Koncepti, Koreografia dhe Regjia: **Prof. msc. Robert Nuha**

Shfaqja Dans Teatër Pas Luftës Kush jemi ne, është realizuar me sukses të jashtëzakonshëm në datën 26 Nëntor në Sallën AMC në Prishtinë, ku e përcollën nga afër më shumë se 1400 njerëz. Me 28 Nëntor në Teatrin Kombëtar të Shqipërisë dhe me 30 Nëntor në Teatrin Shqiptar në Shkup!

Shfaqja ka një rëndësi të veçantë në disa aspekte!

Së pari sepse mbledhi rreth 40 artist, profesionist të fushës të cilët punuan për 3 muaj pa ndalë që të realizojnë një produkt madhështor!

Së dyti, sepse shfaqja prezantoi kulitetet artistike më të larta të njohura në skenën shqiptare, duke u vlerësuar nga kritik arti edhe si Shfaqja e Shekullit

Së treti, shfaqja i përket një gjinie pak të lëvruar në Kosovë, dhe për herë të parë Prishtinën, por edhe Kosovën e kthen në qendër të vëmendjes Europiane përballë produktit të Dans Teatrit dhe Dansit Bashkëkohor!

Së katërti, pjesëmarrja e artistve më në zë të momentit në shfaqje

Së pesti, tematika e cila flet me vuajtjet dhe sakrificat tona për Liri

Së gjashti, Shfaqje që bëhet për nderë të Lavdisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Së shtati, shfaqje e cila kapërcen dimensionet e të zakonshmes, si në pikpamjen e qasjes artistike e gjithashtu edhe nga pikpamja e realizimit dhe interpretimit skenik!

Së teti, shfaqja përfshinë në vehte Dans, Teatër, Muzikë Live, Soprano, Aktrim, Light Desing, Laser, Projeksione etj

Së nënti, është shfaqje Shqiptare, e shkruar dhe punuar Shqip!

Së dhjeti, shfaqje e cila prezanton vlerat më të mira të Kosovës, e sidomos të kryqytetit tonë si në aspektin artistik ashtu edhe në energji rinore, punë dhe dëshirë e jashtëzakonshme e të rinjëve tanë, dashuri dhe përkujtim për të gjithë të rënë e me theks të veçant tek fëmijët e vrarë dhe të zhdukurit!

Ne kërkojmë mbështetje financiare, për ta realizuar shfaqjen në kryqytet, në datat të cilat përkojnë dhe ndërlihen ngusht me atë se çfarë trajton shfaqja, kërkojmë që të na mundësoni ta realizojmë 1 reprizë në nderë të Epopesë së UCK-së në Mars të këtij viti!

Gjithashtu ne tashmë kemi marrë ftesa shumë të rëndësishme për shfaqjen dhe për skenën artistike të Kosovës!

Në datë 5,6 ose 7 Mars dëshirojmë të japim shfaqjen në AMC, Prishtinë, për nderë të Epopesë ë Lvdishme!

Në datë 21 Mars, Shfaqja do të jepet në Teatrin e Gjakovës

Në datë 24 Mars, Shfaqja do të udhtoj për në Francë, Paris, teatri Gymnasium!

Në datë 26 Mars, Shfaqja do jepet në Teatrin e Brukselit

Në datë 14 Shtator, shfaqja do të jepet në Gjermani në festivalin ndërkombëtar Frei Arte

Në datë 27 Nëntor shfaqja do të luhet në Neë York

Dhe datë 28 Nëntor në Dallas!

Për të realizuar gjithë këto udhëtime, me një trupë të madhe, sigurisht që duhet mbështetja institucionale, andaj kërkojmë nga ju të nderuar të na përkrahni në propozimin tonë duke qenë se kjo shfaqje është burim i dashurisë për atdheun, realizohet në nderë të sakrificës sonë për liri dhe u dedikohet 1432 fëmijëve të vrarë në luftën e fundit dhe 1670 të pagjetur akoma!

Shfaqja Pas Luftës Kush jemi Ne prekë zemrat dhe mendjet e secilit që do ketë mundësinë ta ndjekë atë. Gjithashtu, Vlera e trajtimit të tematikës së kombit shqiptar në përgjithësi, e luftës së fundit në veçanti (UÇK-së), është vlerë e shtuar në opusin e shfaqjeve kombëtare, duke tentuar gjithashtu të sjellim risi për nga pikpamja e qasjes bashkëkohore dhe ndërtimit koreografik e skenik të saj!

Tematika ndërlidhet me sakrificën e shumë gjeneratave, të cilën sakrificë e kishin, vetëm që ne të jetojmë dhe të frymojmë lirshëm, andaj realizimi i një ngjarjeje të përmasave të tilla kulturore artistike, i një ndërmarrjeje me qëllime të pastërta dhe të qarta, kërkon një impenjim dhe angazhim të gjërë si dhe kërkon mbështetje financiare! Kalibri i tillë i bashkëpunimeve kombëtare, për idealin dhe luftën e ndritur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është një ndërmarrje që përfshinë një gamë të gjërë krijimtarishë artistike dhe artistët më në zë të trojeve arbërore.!

Ky projekt vjen si rrjedhojë e ecurisë sonë që nga përfundimi i luftës e gjërë më sot, një refleksion i paevitueshëm që urgjentisht duhet ta kemi si shoqëri mbi rezultatet e Lirisë dhe punës që duhet të bëjmë, të përsosim vetveten dhe tu dalim hak atyre që dhanë gjithçka, edhe jetën, që ne të jetojmë të lirë, pas gati dy shekujsh robërie nga barbaria dhe mizoria serbe!

Në këtë periudhë dinamike, me problematika të shumta shoqërore duket se kemi harruar kush jemi dhe nga vijmë, kemi lënë pas dore zakonet e traditat tona të pasura, duke ngarendur pas elementëve ekstremistë, të imponuara qoftë në kulturë e poashtu edhe në art, por edhe në disa rryma religjioze që tashmë po mbizotërojnë (për fat të keq,) dhe shpeshherë po duket që po kalojnë mbi kombin...!

Traditat tona, e kaluara jonë asnjëherë nuk ka lejuar që të dal diçka, çfardo qoftë ajo, mbi kombin e mbi atëdheun, andaj ne si shoqëri e kemi për borgj që të vlerësojmë dhe kujtojmë të gjitha sakrificat e shqiptarve, për më tepër, sakrificën më sublime, atë të flijimit për liri!

Bazuarnë këto që thash më lart dhe në shumë aspekte tjera që na preukupojnë si shoqëri, më poshtë po shkruajnë lidhje me një koncept skenik mbi vuajtjet, sakrificën dhe lirinë e kombit!

Shfaqja Dans Teater, "Pas luftës, kush jemi ne?!",

Është kërkimi i fundit koreografik dhe skenik i koreografit Prof. msc. Robert Nuha – ligjërues në Universitetin shtetëror të Tiranës dhe Kolegjin AAB të Prishtinës, me autorësi të Prof. dr. Nusret Pllanës – ligjërues në Universitetin "Hasan Prishtina" të Prishtinës, me të cilën tentojmë të rikthejmë në vëmendjen tonë, qëndresën, rezistencën, sakrificën, dashurinë për atëdheun, me qëllim që gjeneratat e reja të kenë mundësi të inspirohen

nëpërmjet artit, përvlerat që ne mbartim si shoqëri, gjithashtu të përceptojnë një shfaqje që do ti bëjë ata(ato), ta duan më shumë vendin e tyre, vetveten dhe dashurinë për kombin! Qasja dhe teknikat bashkëkohore të kombinuara me teknika të kërcimit popullor shqiptar do sjellin në skenë magjinë artistike e cila nevojitet për të përcjellur emocionet e duhura për të arritur qëllimin final!

Për shkak të temës së gjërë , me përqëndrim në luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe me heroizmin e pashoq të Komandantit legjendar Adem Jasharit dhe familjes së tij, shfaqja kërkon një numër të konsiderueshëm të artistëve të cilët do të përformojnë në skenë !

Shfaqja ka kërkuar një angazhim të madh në pikpamjen e strukturës si dhe mjeteve shprehëse të aktantve , kërcimtarve si dhe muzikantve të cilët do të realizojnë një vepër të madhe artistike!

Eksodi dhe kalvari i dhimbjes kolektive shqiptare, të pagjeturit(zhdukurit) , heroizmi dhe sakrificat e nënave shqiptare, koha e sotme dhe neglizhenca ndaj kategorive të luftës janë ndër qëllimet kryesore të shfaqjes sonë !

Element të rëndësishëm realizues të shfaqjes mund të jenë përdorimi i instrumenteve popullore shqiptare, qoftë në ndërtimin muzikor por edhe në përfshirje brenda skenës, duke u bërë pjesë e lojës artistike!

Gjithashtu, përfshirja e një Kori profesionist, ose ndërtimi i tij nga fillimi me profesionist të fushës së mbledhur së bashku, mund ti jap fuqinë e nevojshme për realizimin edhe më të gjërë të të gjitha ideve melodike, por jo vetëm...!

Në këtë shfaqje këkohet angazhim i një ekipe të madhe:

Koreograf dhe Regjisor

Assistent Koreograf , Regjisor

Asistent Teknik

Promocion Menagjer

Dramaturg

Skenograf

Videoprojeksion

Aktor Profesionist, 14

Kërcimtar Profesional, 14

Orkestër, 7

Kompozitor

Kor Profesional, 12

Ndriques Skenik

Tonisti

Make ap Artist

Kostumograf

Realizator të Kostumeve!

Video Produksion

Producenti dhe Autori

"Pas luftës, kush jemi ne?!"

Koncepti

Shfaqje *Dans Teatri*, që i flet kohës, rikthehet ne të kaluarën, merr ngjarjet që duhen për ti sjellur tek gjeneratat e reja, për të ndihmuar në refleksion shoqëror mbi Historinë tonë të lavdishme, të metat tona, ndikimet e dëmshme në shoqëri, e mbi të gjitha refleksion kolektiv, për dashurinë ndaj atdheut dhe sakrificën e bërë që ne të jemi të lirë!

Një shfaqje që në veten e saj përfshinë forma artistike mjaft komplekse, që nga gjuha fizike, gjuha e fjalës, Këngët Korale të cilat poashtu do të jenë krijimtari origjinale muzikore, vepër dramatike shkruar nga dramaturg profesional dhe e nxjerrur edhe nga vet procesi i provave, Videoprojeksione dhe Video të cilat së bashku do të krijojnë një gjendje emocionale reflektuese tek të gjithë të pranishmit, dhe jo vetëm...!

"Pass luftës, kush jemi ne?!", do të përfshijë eksodin e dhunshëm të shqiptarëve, historinë e lavdishme të UÇK-së , vrasjen e fëmijëve(1392, vetëm në luftën e fundit gjenocidiale në Kosovë, 1998/1999), gjenocidin serb, të zhdukurit e luftës së fundit,

Skena e Djepit

Gjëma e Burrave, e përpunuar skenikisht. Vajzat me djepa të vendosur në skenë, të cilat mbajnë një ritëm të caktuar, kori këndon këngë ninulla të gërshetuara me gjamën e famshme, një trajtë muzikore bashkëkohore, ndërsa burrat zhvillojnë gjamën e famshme e përcjellur me melodi të lahutës dhe çiftelisë, një vajë force, për jetën e dhënë dhe për lirinë e fituar!

Gjatë gjithë shfaqjes do ketë skena të tilla të cilat na krijojnë imazhe që përceptohet lufta dhe vuajtjet për të arritur efektin e duhur, gjithashtu edhe për të shkuar tek vazhdimësia e betejave që të ruhet gjuha dhe vlerat tona njerëzore, për të përquar idenë dhe qëllimin e pastërt, se Shqiptarët në momente të vështira gjithmonë janë bërë bashkë dhe kanë arritur qëllime të mëdha, pavarësisht pengesave dhe rrymave të momentit!

Në shfaqje do të dominojnë figurat kombëtare, të ardhura edhe në formë skenike por edhe nëpërmjet personazheve që shfaqen herë -herë dhe japin nga një mesazh e prap zhduken, pra shfaqja do të rikthej të gjithë ata që na mungojnë, me qëllim që ne të përjetojmë goditjet e nevojshme emocionale dhe të kthehemi me sy nga na takon, andej nga vijmë, andej nga e kemi obligim dhe andej nga na del më mirë si shqiptar, duke qenë mirënjohës gjithë jetës ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Dëshmorëve e Veteranëve, Nënava e gjithë atyre që derdhën djersë dhe gjak që ne të frymojmë lirshëm, mirënjohës ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës në veçanti (Sponsorit gjeneral të Pavarësisë së Kosovës dardane), dhe gjithë miqve tanë ndërkombëtarë që na ndihmuan kur ne kishim nevojë më së shumti...!

Në skena të plota, akte dramatike dhe zhvillime të ngjarjeve të cilat do lidhen organikisht e gjithashtu edhe në koherencë të plotë në zhvillimet historike, do ketë edhe forma skenike minore, të cilat përshkruajnë një ngjarje a një ndodhi të shkurtër, të domosdoshme, e që ka efekt artistik e ideor! Gjithçka tjetër mund të arrihet në momentin e fillimit të procesit, e shkrimit dramaturgjik. Mënyra Bashkëkohore e provave, Laboratori krijues e eksplorimet skenike mbi temën e lartëpërmendur, puna e vazhdueshme komplekse, e përbashkët, dhe tendenca jonë finale është të arrijmë një vepër të madhe artistike e cila përfshinë artistë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, për tu ribashkuar prap, me një qëllim që nëpërmjet artit të japim mesazhet të cilat janë harruar ose neglizhuar gjithë këto vite nga po vet ne!

Më poshtë po rendisë nevojat buxhetore me qëllim që ky projekt i madh të realizohet!

Plani Buxhetor i projektit artistik i cili do të Realizohet në Prishtinë!

• Salla Teatri	5500 Euro
• Pagesa për Artistët 36 x 220 euro	7920 Euro
• Ambienti i Provave	720 Euro
• Ndriqimi Profesional	1400 Euro
• Fonia Profesionale	1800 Euro
• Promovimi	1200 Euro
• Produksioni	3400 Euro
• Tapeti i Dansit	900 Euro
• Laserat	1100 Euro
• Videoprojeksionet	1000 Euro
• Tonisti	400 Euro
• Ndriquesi	400 Euro
• Koreografi	2200 Euro
• Ass Koreografi	1200 Euro
• Rekuiziteret x 2	900 Euro
• Material shpenzues	700 Euro
• Mezzo Soprano	740 Euro
• Kompozitori	1400 Euro
• Dramaturgu	800 Euro
• Kamera	800 Euro
• Ass Teknik	480 Euro
• Garderobier	400 Euro
• Rekuizita	900 Euro
• Regjistrimi i audios	300 Euro
• Skenografia	1300 Euro
• Koktejt përmbyllës	1100 Euro
• Ushqimi për aktor dhe performues	400 Euro

Totali i shpenzimeve për të realizuar projektin në Prishtinë 39360 Euro

Të realizohet një projekt i përmasave të tilla, mund të themi, më të mëdha nga ndërmarrjet private artistike deri më tani, me një temë kaq aktuale dhe të prekshme, me artistët më në zë, me format më të reja artistike e skenike, me qasjen më bashkëkohore, me tendencat më të mira për shoqërinë dhe kombin tone, mendojmë se është pasuri e shtuar në vlerat e shumta të kombit shqiptar!

Diçka e tillë kërkon mobilizim nga gjithë dashamirët e kombit, artit, kulturës dhe vlerave të Luftës!

Jemi krenarë me lavdinë e popullit tonë dhe, besojmë se e meritojmë që të kemi një vepër artistike të përmasave të tilla në opusin e krijimtarive tona origjinale shqiptare!

Mbesim me shpresën që të na përkrahni, me qëllim që ne të realizojmë një projekt i cili do të kishte një impakt të jashtëzakonshëm kombëtar brenda dhe jashtë vendit!

Me respekt,

*Ideatori dhe producenti, **Prof. dr. Nusret Pllana***

*Koncept, Koreograf dhe Regjisor **Prof. msc. Robert Nuha***





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



**RAPORT FINANCIAR BUXHETOR I KOMUNËS SË
PRISHTINËS
PËR PERIUDHËN 1 TETOR – 30 DHJETOR 2024 (TM 4)**

RAPORTI TREMUJOR ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI
MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
2. Pasqyra e të hyrave për periudhën tetor-dhjetor 2024 dhe krahasimet me vitet paraprake	5
3. Raporti i të hyrave për periudhën tetor-dhjetor 2024, sipas muajve	7
4. Pasqyra e shpenzimeve dhe krahasimet me vitet paraprake	11
5. Pasqyra e shpenzimeve për periudhën tetor-dhjetor 2024.....	12
6. Shpenzimet në projektet kapitale për tremujorin e parë, të dytë dhe të katërt.....	14
7. Raporti për pasurinë jofinanciare.....	21
8. Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPP-së	22
9. Subvencionet për tremujorin e katërt dhe krahasimi me vitet paraprake.....	23
10. Llogaritë e arkëtuara për vitet 2022, 2023, 2024	23
11. Pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve për vitin 2024 dhe krahasimi me vitet paraprake	24
12. Pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve për periudhën tetor-dhjetor 2024	24
13. Raporti “Detyrimet kontingjente nga zyra e përfaqësimit juridik”	25
14. Numri faktik i punonjësve të përhershëm dhe të përkohshëm të organizatave buxhetore krahasuar me numrat e autorizuar në buxhet	26
15. Pagesat faktike të interesit ose shumave në natyrën e interesit në borxh, sikur që është paraparë në nenet 50 dhe 51 të këtij ligji, si dhe për pagesën e shumës kapitale të borxhit	27
16. Detaje mbi të gjithë përfituesit e granteve publike të bëra gjatë vitit fiskal, si dhe shumat të cilat ata i kanë pranuar.....	27
17. Detaje të shpenzimeve nga ndarjet buxhetore për shpenzime të jashtëzakonshme, të përkrahura në nenin 29 të këtij ligji.....	28
18. Detaje mbi të gjitha rregullimet të cilat janë bërë në ndarje buxhetore, në përputhje me nenet 30 dhe 31 të këtij ligji	28

1. Hyrje

Raporti i tremujorit të katërt buxhetor, për periudhën tetor-dhjetor 2024, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga Kryetari i komunës, mbulon tremujorin e katërt të vitit fiskal dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet dhe detyrimet.

Të hyrat vetanake të Komunës gjatë tremujorit të katërt, janë arkëtuar në vlerën e përgjithshme vjetore 24.24 %, ndërsa kanë shënuar rritje prej 28.00 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërkaq, gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 24.99 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria e mallrave, shërbimeve dhe investimeve kapitale.

1.1. Performanca e të hyrave

Grumbullimi i të hyrave buxhetore ka vazhduar gjatë këtij tremujori. Të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rritje prej 28.00 %, që korrespondon me 2,055,872.50 € më shumë krahasuar me tremujorin e vitit paraprak. Kjo rritje ka ardhur në masë të madhe nga mbledhja e të hyrave nga taksat për automjete motorike, leje mjedisore, leje ndërtimore, mbeturina, etj.

1.2. Performanca e shpenzimeve


Shpenzimet buxhetore kanë arritur në 57,882,858.06 € përgjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, apo 24.99 % më shumë krahasuar me shpenzimet e realizuara gjatë së njëjtës periudhë të vitit paraprak. Ndikim në rritjen e shpenzimeve ka pasur në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, investimeve kapitale, subvencioneve dhe transfereve, të cilat janë në vlerën e përgjithshme të buxhetit prej 33.71%.

- ❖ **Shpenzimet për paga dhe mëditje**, gjatë këtij tremujori shënuan vlerën prej 10,326,994.61€, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 23.53 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori gjatë kësaj periudhe. Fatura e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqet një rritje prej 1.90%, apo rreth 192,117.29 € më shumë krahasuar me faturën e pagave në periudhën e njëjtë të vitit 2023.
- ❖ **Shpenzimet në mallra dhe shërbime**, gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në 9,539,720.75€. Kjo shumë korrespondon me 31.93% të buxhetit për këtë kategori për periudhën tetor - dhjetor 2024. Fatura e mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës raportuese, paraqet një rënie prej 22.79%, apo rreth 2,815,379.56 € më pak krahasuar me faturën e mallrave dhe shërbimeve në periudhën e njëjtë të vitit 2023.

- ❖ **Shpenzime në komunalë**, kanë shënuar rritje prej 39.84% krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në 1,738,055.47 €, Kjo shumë korrespondon me 57.91% të buxhetit për këtë kategori, për periudhën tetor-dhjetor 2024. Fatura e komunaleve gjatë periudhës raportuese paraqet një rritje prej 39.84 %, apo rreth 495,176.55 € më shumë krahasuar me faturën e komunaleve në periudhën e njëjtë të vitit 2023.
- ❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, shënuan vlerën prej 1,891,957.16 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 33.12% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë. Te subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rënie prej 12.33 %, apo rreth 266,184.29 € më pak krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjtë të vitit 2023.
- ❖ **Shpenzimet kapitale** janë ekzekutuar me një normë shumë të kënaqshme. Ato arritën vlerën 34,386,130.07 €, që është 38.54 % e planit gjatë kësaj periudhe të vrotuar, të cilat kanë regjistruar rritje prej: 13,965,679.69 € krahasuar me shpenzimet në këtë kategori gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2023, apo rritje prej: 68.39 % në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023.


2. Të hyrat vetanake për tremujorin e katërt të vitit 2024 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2022	2023	2024	Ndryshimi (2023/2024)
	në euro			
1. GJITHSEJ TË HYRA	9,537,762.39	7,343,083.13	9,398,955.63	128.00%
1.1. Të hyrat nga kodi 17506	2,562,652.36	2,103,862.17	2,011,544.75	95.61%
1.1.1 Tatimi në pronën e paluajtshme	2,050,655.86	1,887,741.17	1,778,765.85	94.23%
1.1.2 Taksa për transaksion në pronë	310,500.00	-	-	-
1.1.3 Taksa për automjete motorike	201,496.50	216,121.00	232,778.90	107.71%
1.1.4 Shpronësime	-	-	-	-
1.2. Të hyrat nga kodi 16611	31,420.53	27,118.16	12,671.82	46.73%
1.2.1 Të hyra nga inspeksioni	31,420.53	27,118.16	12,671.82	46.73%
1.3. Të hyrat nga kodi 16306	118,566.95	82,523.05	83,923.14	101.70%
1.3.1 Taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare	118,326.95	73,730.35	82,313.80	111.64%
1.3.2 Të hyrat tjera: tender, kon. tenderi	240.00	8,792.70	1,609.34	-
1.4. Të hyrat nga kodi 18166	1,558,693.56	1,350,507.05	1,529,612.95	113.26%
1.4.1 Taksa për shfrytëzimin e spi. publike	36,595.21	97,311.71	139,827.08	143.69%
1.4.2 Konfiskim i automjeteve	9,224.00	7,407.50	11,354.00	153.28%
1.4.4 Infrastruktura rrugore	816,525.28	768,740.31	451,775.06	58.77%
1.4.5 Mbeturinat	681,823.07	477,047.53	926,656.81	194.25%
1.4.6 Hortikultura	14,526.00	-	-	-
1.5. Të hyrat nga kodi 48006	12,100.00	26,965.99	26,906.91	99.78%
1.5.1 Licenca në biznes	12,100.00	26,965.99	26,906.91	99.78%
1.6. Të hyrat nga kodi 66335	4,547,779.74	2,989,118.55	5,015,977.17	167.81%
1.6.1 Taksa për leje ndërtimi	4,320,174.61	2,800,121.89	4,800,503.49	171.44%
1.6.2 Legalizimi i ndërtimeve pa leje	70,469.62	81,296.34	48,962.94	60.23%
1.6.3 Leje mjedisore komunale	157,135.51	107,700.32	166,510.74	154.61%
1.7. Të hyrat nga kodi 85006, 92311, 73015	346,600.93	373,775.29	393,499.71	105.28%
1.7.1 Biblioteka dhe teatri "Dodona"	9,267.00	7,360.00	9,492.00	128.97%
1.7.2 Taksa për shërbime nga fusha e arsimit	223,803.23	243,330.49	242,177.91	99.53%
1.7.3 Taksa për shërbime shëndetësore	113,530.70	123,084.80	141,829.80	115.23%
1.8. Të hyrat nga kodi 65030	359,948.32	387,558.49	317,972.20	82.04%
1.8.1 Kadastër	359,510.50	386,073.23	298,899.50	77.42%
1.8.2 Qiraja në banesa	437.82	41.10	17,817.50	43351.58%
1.8.3 Shitje e pasurisë	-	1,444.16	1,255.20	-
1.9 Te hyrat nga kodi 47006	-	-	4,530.38	-
1.9 Shfrytëzimi i pronës publike për gjueti	-	-	4,530.38	-
2.0. Të hyrat përmes Thesarit	-	1,654.38	2,316.60	140.03%
2.1 Donacion	-	1,654.38	2,316.60	140.03%



2. Realizimi i të hyrave për periudhën tetor - dhjetor 2024, sipas muajve

Përshkrimi	Buxheti 2024	Gjithsej të realizuara	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Realizimi /Buxheti (në %)
			në euro			
1. GJITHSEJ PRANIMET	38,778,968.00	9,398,955.62	4,398,952.43	1,801,866.55	3,198,136.64	24.24%
1.1. Të hyrat nga kodi 17506	16,655,828.00	2,011,544.75	868,223.17	427,878.56	715,443.02	12.08%
1.1.1 Tatimi në pronën e paluajtshme	14,905,828.00	1,778,765.85	788,595.67	355,681.56	634,488.62	11.93%
1.1.2 Taksa për automjete motorike	750,000.00	232,778.90	79,627.50	72,197.00	80,954.40	31.04%
1.1.3 Shpronësime	1,000,000.00	-	-	-	-	-
1.2. Të hyrat nga kodi 16611	150,000.00	12,671.82	4,800.00	4,377.70	3,494.12	8.45%
1.2.1. Të hyra nga inspeksioni	150,000.00	12,671.82	4,800.00	4,377.70	3,494.12	8.45%
1.3. Të hyrat nga kodi 16306	265,000.00	83,923.14	18,982.34	10,384.00	54,556.80	31.67%
1.3.1 Taksa për certifikata dhe doku. zyrtare	250,000.00	82,313.80	17,373.00	10,384.00	54,556.80	32.93%
1.3.2 Të hyrat tjera: tenderë, kon. tënd.	15,000.00	1,609.34	1,609.34	-	-	10.73%
1.4. Të hyrat nga kodi 18166	7,538,000.00	1,529,612.95	404,865.45	406,381.42	718,366.08	20.29%
1.4.1 Taksa për shfrytëzimin e sip. publike	100,000.00	139,827.08	69,840.22	33,220.20	36,766.66	139.83%
1.4.2 Konfiskim i automjeteve	100,000.00	11,354.00	5,492.50	3,172.00	2,689.50	11.35%
1.4.3 Infrastruktura rrugore	3,000,000.00	451,775.06	90,274.45	205,545.03	155,955.58	15.06%
1.4.4 Mbeturinat	4,338,000.00	926,656.81	239,258.28	164,444.19	522,954.34	21.36%
1.5. Të hyrat nga kodi 48006	250,000.00	26,906.91	5,772.00	3,230.16	17,904.75	10.76%
1.5.1 Licenca në biznes	250,000.00	26,906.91	5,772.00	3,230.16	17,904.75	10.76%
1.6. Të hyrat nga kodi 66335	11,685,140.00	5,015,977.17	2,865,711.84	741,877.39	1,408,387.94	42.93%
1.6.1 Taksa për leje ndërtimi	10,735,140.00	4,800,503.49	2,749,671.42	663,460.88	1,387,371.19	44.72%
1.6.2 Legalizimi i ndërtimeve pa leje	350,000.00	48,962.94	18,427.44	18,733.27	11,802.23	13.99%
1.6.3 Leje mjedisore komunale	600,000.00	166,510.74	97,612.98	59,683.24	9,214.52	27.75%
1.7. Të hyrat nga kodi 85006, 92311, 73015	1,220,000.00	393,499.71	121,632.31	120,625.57	151,241.83	32.25%
1.7.1 Biblioteka dhe teatri "Dodona"	20,000.00	9,492.00	1,762.00	1,906.00	5,824.00	47.46%
1.7.2 Taksa për shërbime nga fusha e arsimit	800,000.00	242,177.91	77,823.81	83,832.57	80,521.53	30.27%
1.7.3 Taksa për shërbime shëndetësore	400,000.00	141,829.80	42,046.50	34,887.00	64,896.30	35.46%
1.8. Të hyrat nga kodi 65030	1,015,000.00	317,972.20	104,434.95	84,795.15	128,742.10	31.33%
1.8.1 Kadastër	1,000,000.00	298,899.50	104,421.25	84,342.25	110,136.00	29.89%
1.8.2 Qiraja në banesa, Renta AKP	-	17,817.50	13.70	13.70	17,790.10	-
1.8.3 Shitje e pasurisë	15,000.00	1,255.20	-	439.20	816.00	8.37%
1.9 Te hyrat nga kodi 47006	-	4,530.37	4,530.37	-	-	-
1.9 Shfrytëzimi i pronës publike për gjueti	-	4,530.37	4,530.37	-	-	-
2.0. Të hyrat përmes Thesarit	-	2,316.60	-	2,316.60	-	-
2.0 Donacion	-	2,316.60	-	2,316.60	-	-




Komuna e Prishtinës ka arkëtuar gjithsej **9,398,955.62€** të hyra vetanake për tremujorin e katërt të vitit 2024, apo 24.24 % të të hyrave të planifikuara për këtë vit. Shumica e të hyrave në vlerë absolute janë nga taksa për transaksion për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, të hyra nga kadastri, taksat për leje ndërtimi etj.

3.1. Të ardhurat faktike, të identifikuar sipas llojit të organizatave buxhetore, të krahasuara me parashikimet përkatëse, të cilat janë përfshirë në buxhet.

Komuna e Prishtinës ka planifikuar gjithsej 38,778,968.00 € të hyra vetanake për vitin 2024, prej të cilave në tremujorin e katërt ka realizuar 24.24 %.

3.2. Të hyrat vetanake të realizuara sipas muajve për vitin 2024

Përshkrimi	Buxheti 2024	Gjithsej të realizuara	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Realizimi /Buxheti (në %)
			në Euro					në Euro							
1. GJITHSEJ PRANIMET	38,778,968.00	32,344,595.94	1,399,265.94	1,668,023.91	2,137,282.31	3,610,692.41	3,403,992.40	2,496,759.16	2,202,277.11	3,112,583.49	2,914,763.59	4,398,952.43	1,801,866.55	3,198,136.64	83.41%
1.1. Të hyrat nga kodi 17506	16,655,828.00	9,537,101.98	511,615.39	623,813.64	711,411.30	1,875,889.12	1,285,827.98	404,951.88	490,064.29	665,448.14	956,535.49	868,223.17	427,878.56	715,443.02	57.26%
1.1.1 Tatimi në pronën e paluajtshme	14,905,828.00	8,618,214.38	451,163.89	556,293.64	641,439.80	1,806,537.12	1,206,777.98	321,619.88	394,412.59	580,398.14	880,805.49	788,595.67	355,681.56	634,488.62	57.82%
1.1.3 Taksa për automjete motorike	750,000.00	918,887.60	60,451.50	67,520.00	69,971.50	69,352.00	79,050.00	83,332.00	95,651.70	85,050.00	75,730.00	79,627.50	72,197.00	80,954.40	122.52%
1.1.5 Shpronësime	1,000,000.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%
1.2. Të hyrat nga kodi 16611	150,000.00	76,843.64	3,885.15	4,951.85	10,908.40	9,133.47	7,675.00	5,500.00	8,749.91	10,122.84	3,245.20	4,800.00	4,377.70	3,494.12	51.23%
1.2.1 Të hyra nga inspeksioni	150,000.00	76,843.64	3,885.15	4,951.85	10,908.40	9,133.47	7,675.00	5,500.00	8,749.91	10,122.84	3,245.20	4,800.00	4,377.70	3,494.12	51.23%
1.3. Të hyrat nga kodi 16306	265,000.00	200,530.84	3,120.00	10,579.00	14,316.40	9,697.00	18,118.30	9,322.00	13,416.00	23,713.80	14,325.20	18,982.34	10,384.00	54,556.80	75.67%
1.3.1 Taksa për certifikata dhe doku. zyrtare	250,000.00	198,803.90	3,120.00	10,579.00	14,311.40	9,697.00	18,118.30	9,322.00	13,416.00	23,601.20	14,325.20	17,373.00	10,384.00	54,556.80	79.52%
1.3.2 Të hyrat tjera: tender, kon. tenderi	15,000.00	1,726.94	-	-	5.00	-	-	-	-	112.60	-	1,609.34	-	-	11.51%
1.4. Të hyrat nga kodi 18166	7,538,000.00	6,178,019.80	203,258.53	453,259.18	369,574.13	474,138.88	509,315.01	269,015.49	551,123.84	933,720.52	885,001.27	404,865.45	406,381.42	718,366.08	81.96%
1.4.1 Taksa për shfrytëzimin e sip. publike	100,000.00	651,447.69	3,417.62	6,801.89	8,353.40	16,791.07	61,585.64	71,206.26	129,388.22	166,404.13	47,672.38	69,840.22	33,220.20	36,766.66	651.45%
1.4.2 Konfiskim i automjeteve	100,000.00	54,894.25	1,472.50	2,105.00	2,122.50	5,270.00	6,779.75	5,645.00	8,706.25	6,965.50	4,473.75	5,492.50	3,172.00	2,689.50	54.89%
1.4.3 Infrastruktura rrugore	3,000,000.00	2,396,604.57	21,845.02	134,278.43	134,669.93	233,496.20	284,295.66	75,609.71	274,737.79	442,058.75	343,838.02	90,274.45	205,545.03	155,955.58	79.89%
1.4.4 Mbeturinat	4,338,000.00	3,075,073.29	176,523.39	310,073.86	224,428.30	218,581.61	156,653.96	116,554.52	138,291.58	318,292.14	489,017.12	239,258.28	164,444.19	522,954.34	70.89%
1.5. Të hyrat nga kodi 48006	250,000.00	189,519.68	27,942.85	7,311.03	48,851.30	7,980.00	10,605.15	9,609.88	22,433.37	18,640.19	9,239.00	5,772.00	3,230.16	17,904.75	75.81%
1.5.1 Licenca në biznes	250,000.00	189,519.68	27,942.85	7,311.03	48,851.30	7,980.00	10,605.15	9,609.88	22,433.37	18,640.19	9,239.00	5,772.00	3,230.16	17,904.75	75.81%
1.6. Të hyrat nga kodi 66335	11,685,140.00	13,190,502.14	406,535.38	352,737.80	749,526.50	898,700.04	1,298,723.39	1,539,442.77	841,981.94	1,269,421.16	817,455.99	2,865,711.84	741,877.39	1,408,387.94	112.88%
1.6.1 Taksa për leje ndërtimi	10,735,140.00	12,342,191.88	392,905.73	324,354.92	686,461.11	817,122.83	1,217,069.49	1,440,740.60	712,605.26	1,195,707.76	754,720.69	2,749,671.42	663,460.88	1,387,371.19	114.97%
1.6.2 Legalizimi i ndërtimeve pa leje	350,000.00	149,089.55	331.37	1,336.36	5,405.91	59,109.42	6,049.74	1,212.75	9,447.90	7,129.98	10,103.18	18,427.44	18,733.27	11,802.23	42.60%
1.6.3 Leje mjedisore komunale	600,000.00	699,220.71	13,298.28	27,046.52	57,659.48	22,467.79	75,604.16	97,489.42	119,928.78	66,583.42	52,632.12	97,612.98	59,683.24	9,214.52	116.54%
PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndëreveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin joformal të grave asambleste, organizatat ndërkombëtare, Kuvendin komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Kryeqytetit Prishtinë, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë, në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Barazia gjinore nënkupton që qeniet njerëzore, gratë dhe burrat, janë të lirë t’i zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).¹

Siç përshkruhet edhe në tekstin e “Kartës evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale”², njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve lokalë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave³, të rejave dhe të rinjve⁴, vajzave dhe djemve.⁵

Zbatimi dhe promovimi i së drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si një çështje me përparësi në nivel vendi, e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në “Programin e Kosovës për barazi gjinore 2020 – 2024”, i cili bazohet në “Ligjin nr. 05/L -020”, për barazi gjinore, jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes, si dhe objektivat specifike për zbatimin e të cilave duhet të punojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.

¹ Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

² Tekstin e Kartës mund ta gjeni në: <https://charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-en.html>

³ “Gra dhe burra” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

⁴ “Të reja dhe të rinj” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 29 vjeç.

⁵ “Vajza dhe djem” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç.

Kryeqyteti Prishtinë, në misionin e tij shprehet se “...Prishtina e së ardhmes është qytet me shërbime efikase e cilësore, të cilat janë në funksion të mirëqenies së përgjithshme të qytetareve/qytetarëve të saj. Qytet me planifikim urban e hapësinor të mirëfilltë, i cili e bën kryeqytetin qendër të sigurt për një jetë të begatshme socio-ekonomike, kulturore, arsimore, sportive, dhe duke siguruar mirëqenie dhe cilësi të jetës për qytetaret/qytetarët e Kryeqytetit Prishtinë. Qytet me model të qeverisjes efikase dhe transparente, dhe si i tillë, të shërbejë si model edhe për qeverisje në komunat tjera në Kosovë, duke ndikuar kështu në rritjen e mirëqenies për tërë qytetaret/qytetarët e Kosovës...”⁶

Në zbatim të kornizës ligjore e të politikave në fuqi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, si dhe në përputhje me misionin dhe vizionin e saj, Kryeqyteti Prishtinë, ka emëruar një zyrtarë për koordinimin e të drejtave të njeriut (ZKDNJ), e cila në mënyrë të përvitshme harton dhe zbaton një plan të veprimeve konkrete për përparimin drejt barazisë gjinore. Ky plan e ka gjetur zbatimin me mbështetjen financiare nga Kryeqyteti dhe donatorë, përmes partneriteteve e bashkëpunimit.

Megjithatë, pavarësisht përparimit të bërë në këtë drejtim në nivel vendor apo komunal, duhet të pranohet që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda së njëjtës gjini, vijnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtaura mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

PLVBGJ 2025 – 2026, është konceptuar dhe lidhur pikërisht me kornizën ligjore dhe të politikave kombëtare, por mbështetet dhe merr frymëzim edhe nga dokumentet ndërkombëtarë të rëndësishëm, e synon të përafrohet me standardet dhe kërkesat e “*acquis*” të BE-së për barazinë gjinore. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan, janë hartuar duke pasur parasysh faktin që asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjitha/gjithë anëtareve dhe anëtareve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PLVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja “**në të gjithë diversitetin e tyre**”.⁷ Përmes saj theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave (por edhe burrave, të rinjve e djemve) në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur, për shkak të seksit, moshës, zonës ku jetojnë, etnisë, aftësive të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, të qenit prind i vetëm, të qenit viktimë / e mbijetuar / i mbijetuar i trafikimit të qenieve njerëzore, apo formave të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statusit të migrantës / migrantit, azilkërkuessës / azilkërkuessit, apo për shkak të të qenit “person në mbrojtje ndërkombëtare” (pra me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe në mbrojtje plotësuese), me status “pa shtetësi” etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PLVBGJ 2025 - 2026, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësitë për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesore ku mbështeten hapat e planifikuar.

⁶ <https://kk.rks-gov.net/prishtine/>

⁷ Në kuadër edhe të përafritimit të këtij Plani lokal të veprimit për barazinë gjinore me Planin e veprimit të BE-së për barazinë gjinore – EU GAP III.

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sikurse “Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (njohur si CEDAW), “Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi gratë, paqen dhe sigurinë”, apo “Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën e dhunës ndaj grave e dhunës në familje” (e njohur si “Konventa e Stambollit”), drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast konflikti konsiderohet që këto konventa kanë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucionet publike.

“Ligji për vetëqeverisje lokale”, themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

“Ligji për barazi gjinore”, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Programi i Kosovës për barazi gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.⁸

Plani lokal i veprimit për barazinë gjinore 2025 - 2026 i Kryeqytetit Prishtinë, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishme ligjore dhe institucionale, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Kosovë. Si më kryesoret mund të përmendim:

1. Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- “Deklarata universale për të drejtat e njeriut”;⁹
- “Konventa evropiane për të drejtat e njeriut”;¹⁰
- “Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike”;¹¹
- “Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore”;¹²
- “Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW)”;¹³
- “Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës”;¹⁴
- “Deklarata dhe Platforma për veprim e Pekinit”;¹⁵
- “Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”;¹⁶
- “Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi gratë, paqen dhe sigurinë”;¹⁷
- “Agjenda e Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm, 2030”;¹⁸
- “Strategjia e barazisë gjinore 2020 - 2025 e Bashkimit Evropian”¹⁹ dhe “Plani i veprimit për barazinë gjinore (GAP III) 2021 – 2025”;²⁰

⁸ Shih PKBGJ, fq. 11

⁹ <https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>

¹⁰ https://prd-echr.coe.int/documents/d/echr/Convention_SQI

¹¹ <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>

¹² <https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/Ahri.htm>

¹³ <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Konvent%20CEDAW.pdf>

¹⁴ <https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/AConRightsChild.pdf>

¹⁵ <https://awenetwork.org/media/6462066697d99.pdf>

¹⁶ <https://rm.coe.int/168046246b>

¹⁷ <https://abgj.rks->

<gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Rezoluta%201325%20Gruaja%20Paqia%20dhe%20Siguria.pdf>

¹⁸ <https://humanrights.oik-rks.org/goals>

¹⁹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0152>

²⁰ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020JC0017&from=EN>

- Direktiva (BE) 2019/1158 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 qershor 2019 mbi balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët;²¹
- Direktiva (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 maj 2024 për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;²²
- “Karta Evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale”²³ etj.

2. Korniza ligjore dhe zhvillimore kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, neni 7, 21 dhe 22;²⁴
- “Ligji për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040”;²⁵
- “Ligji për barazi gjinore, nr. 05/L-020”;²⁶
- “Ligji për trashëgiminë në Kosovë nr.2004/26”;²⁷
- “Ligji nr. 06/L-077, për ndryshim- plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës”;²⁸
- “Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, nr.05/L-021”;²⁹
- “Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, nr. 03/L-154”;³⁰
- “Ligji i punës, nr. 03/L-212”;³¹
- “Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, nr. 08/L-185”;³²
- “Ligji nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare”;³³
- “Ligji nr. 04/l-096 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë”;³⁴
- “Ligji nr. 03/L022, për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme”;³⁵
- “Ligji nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit”;³⁶
- “Ligji nr. 06/L-084, për mbrojtjen e fëmijës”;³⁷
- “Ligji nr. 04/L-125, për shëndetësi”;³⁸
- “Ligji nr. 06/L-026, për azil”³⁹
- “Ligji nr. 03/l-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit”;⁴⁰
- “Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024”;⁴¹
- “Strategjia kombëtare për zhvillim - 2030”⁴²
- “Programi për reforma në ekonomi (PRE) 2022 - 2024”;⁴³

²¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32019L1158#PP4Contents>

²² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32024L1385>

²³ https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

²⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

²⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

²⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2407>

²⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18420>

²⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

³⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2643>

³¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

³² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83131>

³³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85111>

³⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2826>

³⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2582>

³⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66178>

³⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

³⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8666>

³⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16389>

⁴⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

⁴¹ <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024.pdf>

⁴² <https://kryeministri.rks-gov.net/strategjia-kombetare-per-zhvillim-2030/>

⁴³ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Programi-per-Reforma-ne-Ekonomi-2022-24.pdf>

- “Strategjia për rregullim me të mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021”;⁴⁴
- “Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026”;⁴⁵
- “Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2022-2026”;⁴⁶
- “Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë”⁴⁷ dhe “Plani i veprimit të Strategjisë kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë”⁴⁸;
- “Plani i veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor 2023-2025”⁴⁹, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PLVBGJ 2025 – 2026, kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët e caktuar sipas fushave të tyre.

Përgjegjës kryesor për zbatimin e PLVBGJ-së mbetet **Kryeqyteti**. Kjo nënkupton përgjegjësi si për zbatim të drejtpërdrejtë të masave dhe veprimeve të parashikuara, ashtu edhe për koordinimin me institucionet dhe aktorët përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave dhe veprimeve. Pra nëse Kryeqyteti nuk ka mundësi financiare, njerëzore apo infrastrukurore që të zbatojë drejtpërdrejt një masë apo veprim të caktuar, përgjegjësia e tij është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me atë institucion që e ka këtë mundësi, duke përfshirë edhe OJQ, institucionet private, organizatat ndërkombëtare etj. Zyrtarja për koordinimin e të drejtave të njeriut (ZKDNJ) do të mbetet përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e një sërë masash dhe veprimesh të parashikuara në PLVBGJ, por, tashmë ky është një plan i gjithë Kryeqytetit, ndaj dhe përgjegjësia kryesore për këtë plan në tërësi jo domosdoshmërisht bie mbi ZKDNJ. Gjithashtu, PLVBGJ 2025 - 2026, i zbërthyer vit pas viti, zëvendëson edhe Planin e veprimit për barazinë gjinore që ZKDNJ përgatiste dhe paraqiste përpara Kryetarit të Kryeqytetit dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, në mënyrë të përvitshme.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore në nivelin lokal, luan edhe Grupi jo formal i grave asambliste, të cilat gjithashtu kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për hartimin e këtij Plani. Në vijim, të gjitha institucionet lokale dhe OJQ të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PLVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PLVBGJ.

Plani lokal i veprimit për barazinë gjinore, është:

- një **mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishme kombëtare, por edhe ndërkombëtare në lidhje me barazinë gjinore** (veçanërisht instrumentet drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit).
- një **dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës**, me hapa të mirë përcaktuar, e **në përmbajtje të të cilit reflektohen arritjet dhe sfidat** e ndeshura ndër vite nga Kryeqyteti, **në përparimin drejt barazisë gjinore**.
- një **pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësive të domosdoshme** për t’u përmbushur brenda Kryeqytetit Prishtinë, si dhe ndërmjet Kryeqytetit e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim **zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë**, në të gjithë diversitetin e tyre, në Kryeqytetin Prishtinë.

⁴⁴ <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/010D4102-371B-4279-A99E-B9E73DBFFD2F.docx>

⁴⁵ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombe%CC%88tare-pe%CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne%CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>

⁴⁶ https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/1-PKZMSA-2022-2026_shq.pdf

⁴⁷ <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/2EB649CB-988B-4F74-86ED-926CDE060F0B.pdf>

⁴⁸ <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/223C9285-0D8F-418E-88B3-19C5A8EF4432.pdf>

⁴⁹ <https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Plani42004910.6704.pdf>

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PLVBGJ 2025 – 2026, ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- ✓ **Ngritja e Grupit punues për përgatitjen e këtij plani, me Vendim të Kryetarit të Kryeqytetit.** Grupi punues për përgatitjen e këtij PLVBGJ u ngrit me Vendim të Kryetarit, nr. 14-020/4-191188/23, datë 14.09.2023.
- ✓ **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues.** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues të Kryeqytetit, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kornizës ligjore dhe të politikave ekzistuese kombëtare e lokale, të lidhura me çështjet gjinore.
- ✓ **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes,** të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PLVBGJ 2025 - 2026. Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, si vlerësimi i arritjeve dhe sfidave të Kryeqytetit për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, identifikimi i prioritetëve bazuar në analizën e cekur më sipër, marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të dala nga diskutimet me stafin e Kryeqytetit etj.
- ✓ **Konsultimet paraprake brenda Kryeqytetit dhe hartimi i projekt PLVBGJ.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e Kryeqytetit, si dhe në veçanti me anëtarët / anëtarët e Grupit punues dhe me Grupin joformal të grave asambleiste. Që nga fillimi i këtyre konsultimeve u prezantuan instrumente kryesore të rëndësishme ndërkombëtare, sidomos ato të BE-së të lidhura me barazinë gjinore (si për shembull “Plani i veprimit i BE-së për barazinë gjinore” / EU GAP III, apo “Karta evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale” etj.). Po kështu u prezantuan edhe prioritetet e cekura në dokumente të rëndësishme kombëtare, si Programi i Kosovës për barazinë gjinore 2020 - 2024, Plani i zbatimit në nivel vendi për Kosovën, i Planit të veprimit të BE-së për barazinë gjinore III, 2021 – 2025 etj. Më pas u kalua në përgatitjen e projekt matricës së PLVBGJ-së, e cila përmbante objektivat strategjikë, rezultatet e pritshme, dokumentet se ku referoheshin masat dhe veprimet e parashikuara, objektivat specifikë, treguesit në nivel objektiv, së bashku me vlerën bazë (e matur për vitin 2024 ose që do përcaktohet gjatë vitit 2025) dhe vlerën e synuar (target) deri në vitin 2026, rezultatit në nivel të objektivit specifik, si dhe aktivitetet, drejtorinë përgjegjëse për zbatim, partnerët dhe bashkëpunëtorët, afatin kohor, koston për tri vitet, burimin e financimit, treguesit për çdo aktivitet, si dhe përgjegjësitë për monitorimin e zbatimit të PLVBGJ.
- ✓ **Postimi në faqen e Kryeqytetit për komente dhe sugjerime nga individë dhe grupe të interesit.** Draft-PLVBGJ 2024 – 2026, u postua më 15 tetor 2024, në linkun <https://prishtinaonline.com/lajmet/4237/konsultim-publik-plani-per-barazi-gjinore-2024-2026-nga-komuna-e-prishtines>. Postimi qëndroi i hapur për komente dhe sugjerime deri më 14 nëntor 2024, duke plotësuar kështu detyrimin për konsultimin publik, në mbështetje të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03L-040 dhe Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 04/2023, për administratë të hapur në komuna.
- ✓ **Mbajtja e konsultimit publik me banoret dhe banorët e Kryeqytetit.** Në përputhje dhe vijim të asaj që u cek më sipër, Kryeqyteti Prishtinë mbajti edhe sesionin e dëgjimit publik, më 4 nëntor 2024, në orën 10.00.
- ✓ **Përmirësimi i draft-PLVBGJ-së.** Pas seancës së dëgjimit publik dhe në përfundim të të gjithë procesit të konsultimit publik, Grupi punues bëri edhe përmirësimin e draft-PLVBGJ, bazuar në të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra.
- ✓ **Kostimi i matricës së PLVBGJ-së.** Procesi i kostimit të matricës së PLVBGJ ishte një proces tepër i rëndësishëm, që gjithashtu mori kohën e tij përgjatë përgatitjes së dokumentit të plotë. Kostimi u krye për secilin nga aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ-së dhe fondet

u ndanë sipas burimit të financimit, konkretisht fonde të mbuluara nga Kryeqyteti, me burime ekzistuese njerëzore, infrastrukturore apo financiare, fonde të mbuluara nga donatorët, por edhe fonde për gjetjen e të cilave duhet të bëhen rishikime dhe planifikime në buxhetet përkatëse të viteve të ardhshme, ose duhet të llobohet për t'i siguruar përmes bashkëpunimit me donatorët, subjektet private e OJQ-të (pra hendeku financiar).

- ✓ **Dorëzimi i dokumentit të plotë, të kostuar e përfunduar për miratim në Kuvendin komunal.** Pas përgatitjes dhe përfundimit të të gjithë procesit, dokumenti i plotë i PLVBGJ, dhe i kostuar, u dorëzua për miratim në Kuvendin komunal, duke ndjekur të gjithë hapat, detyrimet dhe afatet ligjore përkatëse.
- ✓ **Miratimi i PLVBGJ-së në Kuvendin komunal.** PLVBGJ u miratua në mbledhjen e radhës së Kuvendit komunal, në janar 2025.

Të gjithë hapat e mësipërm shkojnë në linjë jo vetëm me detyrimet kombëtare, por edhe me metodologjinë e përgatitjes së PLVBGJ-ve siç sugjerohet nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).⁵⁰

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PLVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Women Kosovë, përmes një ekipi të mirë përgatitur, si dhe një konsulenteje⁵¹ të angazhuar për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) që financohet nga Bashkimi Evropian.

IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni i PLVBGJ-së adreson:

“Një qeverisje të mirë, gjithëpërfshirëse e të drejtë gjinore, ku gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Prishtinës, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantës/migrantit e azilkërkuës/azilkërkuësit, statusit të “personit nën mbrojtje ndërkombëtare” (me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), statusit “pa shtetësi”, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Parimet⁵² që udhëheqin zbatimin e PLVBGJ, mbështeten kryesisht në parimet që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale, siç paraqiten në vijim:

1. **Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.** Kjo e drejtë duhet të zbatohet nga organet e vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë; ajo përfshin gjithashtu edhe detyrimin për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit, të drejtpërdrejta apo të tërthorta.
2. **Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.** Përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore duhet të marrin parasysh dhe të trajtojnë – nga një këndvështrim gjithëpërfshirës, sistemik dhe strukturor – mënyrat se si ndër vepron gjinia me faktorë të tjerë si seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina etnike ose sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionet politike dhe çfarëdo opinionesh të tjera,

⁵⁰ Për më shumë shikoni në: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>

⁵¹ Znj. Monika Kocaqi, konsulente ndërkombëtare.

⁵² Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, origjina në lindje, aftësitë e kufizuara, mosha, ose orientimi seksual.

3. **Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.** E drejta për barazi të grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, kërkon që organet vetëqeverisëse lokale të marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë të gjitha strategjitë e përshtatshme për promovimin e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes së balancuar në të gjitha sferat e vendimmarrjes.
4. **Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.** Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të nxisin punën për eliminimin e stereotipeve dhe pengesave që krijojnë pabarazi në statusin dhe gjendjen e grave / të rejave / vajzave dhe që janë burimi i vlerësimit të pabarabartë të roleve të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve nga pikëpamja politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.
5. **Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes lokale është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.** Perspektiva gjinore duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullsisë lokale – për shembull përmes përdorimit të teknikave të “vlerësimeve gjinore”, “auditimit gjinor”, “integritimit gjinor”, dhe të “buxhetimit të përgjegjshëm gjinor”. Për arritjen e këtij synimi duhet të analizohen dhe të merren parasysh përvojat e shumta dhe të gjera të grupeve të ndryshme të grave në jetën lokale, si edhe kushtet e jetesës dhe të punës së tyre.
6. **Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.** Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të hartojnë plane dhe programe veprimi për barazinë gjinore, të mbështetura me burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

Objektivat strategjikë të PLVBGJ-së.

PLVBGJ 2025 – 2026, përbëhet nga katër objektiva strategjike, të cilat janë harmonizuar edhe me:

- Ligjin nr. 05/L -020 për barazi gjinore;
- Programin e Kosovës për barazinë gjinore 2020 – 2024;
- Planin e zbatimit në nivel vendi për Kosovën të Planit të veprimit të BE-së për barazinë gjinore III (EU GAP III) 2021-2025;
- Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW);
- Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit);
- Deklaratën dhe platformën për veprim të Pekinit (BDPfA);
- Agjendën 2030, Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs) 2030;
- Planin e veprimit për barazinë gjinore të BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III);
- Direktivën (BE) 2019/1158 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 qershor 2019 mbi balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët;
- Direktivën (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 maj 2024 për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- Kartën evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale etj.

Katër objektivat strategjike të PLVBGJ-së 2025 - 2026 të Kryeqytetit Prishtinë, renditen në vijim:

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre;
2. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave;

3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre;
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Secila nga këto objektiva strategjike është zërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PLVBGJ-së kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale, organizatat e shoqërisë civile, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PLVBGJ-së.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit

<p>Objektivi strategjik:</p> <p>1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>1.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e Kryeqytetit për përmbushjen e angazhimit publik zyrtar për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.</p> <p>1.b. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen publike të Kryeqytetit, e përmirësuar.</p>
<p>Objektivat specifike:</p> <p>1.1. Rritja e vetëdijesimit të grave, të rejave e vajzave të Kryeqytetit, në të gjithë diversitetin e tyre, mbi të drejtat dhe mundësitë e barabarta në çdo fushë.</p> <p>1.2. Zbatimi në praktikë i integritimit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si mjete për përparimin e Kryeqytetit drejt barazisë gjinore.</p>
<p>Treguesit në nivel objektivi:</p> <p>1.1.a. Përqindja e grave, të rejave e vajzave të Kryeqytetit e vetëdijesuar mbi të drejtat e tyre të barabarta si dhe rëndësinë e ofrimit të mundësive dhe angazhimit të barabartë për të gjitha/gjithë.</p> <p>1.2.a. Përqindja e buxhetit të Kryeqytetit dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>2. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>2.a. Praktika e Kryeqytetit për t'u krijuar grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, mundësi për ndërmarrësi dhe punë të denjë, nëpërmjet krijimit të lehtësirave fiskale dhe mbështetjes me mjete monetare, e përmirësuar ndjeshëm.</p> <p>2.b. Më shumë qasje në shërbime sociale cilësore të përgjegjshme gjinore për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat e djemtë e Kryeqytetit, në të gjithë diversitetin e tyre.</p>
<p>Objektivat specifike:</p> <p>2.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve dhe produkteve financiare dhe burimeve produktive, me fokus zhvillimin ekonomik në zonat rurale dhe ekonominë mjedisore.</p>

<p>2.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.</p>
<p>Treguesit në nivel objektiv:</p> <p>2.1.a. Përqindja e buxhetit të Kryeqytetit dedikuar për subvencione (në sektorin e bujqësisë), që mbështesin gratë në bujqësi si pronare dhe/ose punonjëse të bizneseve.</p> <p>2.2.a. Përqindja e grupeve të cënueshme të përfshira në shërbime sociale dhe rezidenciale, me fokus janë gratë, të rejtat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>3.a. Qasja e grave, të rejave dhe vajzave, si dhe djemve, të rinjve e burrave, në të gjithë diversitetin e tyre, në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, e përmirësuar ndjeshëm.</p> <p>3.b. Më shumë vajza, të reja dhe gra të Kryeqytetit, të angazhuara në aktivitete sportive e kulturore</p>
<p>Objektivat specifike:</p> <p>3.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Kryeqytetit, në të gjithë diversitetin e tyre.</p> <p>3.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në kulturë dhe sport.</p>
<p>Treguesit në nivel objektiv:</p> <p>3.1.a. Përqindja e studenteve vajza të Kryeqytetit që përfitojnë bursa, duke evidentuar mes tyre studentet që zgjedhin të studiojnë në shkencë, teknologji, informatikë, matematikë (SHTIM).</p> <p>3.1.b. Përqindja e grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, fituese për “subvencionet në kulturë” dhe subvencionet në sport”.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>4.a. I jepet vëmendje edukimit mbi shëndetin seksual e riprodhues të personelit arsimor dhe nxënësve e nxënësve në shkollat e mesme profesionale të Kryeqytetit.</p> <p>4.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.</p>
<p>Objektivi specifik:</p> <p>4.1. Avancimi i barazisë gjinore me anë të gjithëpërfshirjes në promovim, kujdes dhe edukim shëndetësor, si dhe për shëndetin seksual e riprodhues.</p>
<p>Tregues në nivel objektiv:</p> <p>4.1.a. Përqindja e nxënësve/ nxënësve të përfshirë në aktivitete edukuese mbi shëndetin dhe të drejtat seksuale e riprodhuese, që demonstron një njohuri të përmirësuar në këtë drejtim.</p>

V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ-SË 2025 - 2026

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ-së 2025 – 2026, shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zberthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Kryeqyteti (si me burimet ekzistuese njerëzore, financiare e infrastrukturore, ashtu edhe me burime që duhet të shtojë), kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Kryeqyteti e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra zyrtareve / zyrtarëve, të cilat/cilët aktualisht marrin një pagë fikse, sallave/ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin etj.), në këtë Plan lokal veprimi për barazinë gjinore 2025 – 2026, evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë

fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani lokal të veprimit për barazinë gjinore 2025 - 2026, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PLVBGJ nuk merr jetë, Kryeqyteti duhet të përfshijë në kornizën e parashikimeve buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në këtë PLVBGJ. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë Grupi Joformal i Grave Asambliste për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve/masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Kryeqytetit, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Lokal të Veprimit, **duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara**, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo KAB-et e Kryeqytetit, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar, sidomos në periudhën e përgatitjes së KAB-eve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PLVBGJ-së, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezultojnë se kostot në tërësi për zbatimin e PLVBGJ-së 2025 - 2026 janë në vlerë **7,517,160 EUR**. Nga këto:

- **34,561 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
- **2,640,214 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 2. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejtat dhe vajzat. Këtu përfshihen edhe subvencionet në total për të gjithë vitin dhe ndarja e përqindjes që shkon për gratë, të rejtat dhe vajzat, do të bëhet në raportimin e çdo fundviti.
- **4,482,396 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre. Këtu përfshihen edhe subvencionet në total për të gjithë vitin dhe ndarja e përqindjes që shkon për gratë, të rejtat dhe vajzat, do të bëhet në raportimin e çdo fundviti.
- **359,989 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese. Këtu përfshihen edhe subvencionet në total për të gjithë vitin dhe ndarja e përqindjes që shkon për gratë, të rejtat dhe vajzat do të bëhet në raportimin e çdo fundviti.

Në totalin e kostos **7,517,160 EUR** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PLVBGJ-së 2025 - 2026 për të gjithë kohëzgjatjen e tij (tri vjet):

- **7,509,181 EUR janë kosto që do të mbulojnë nga Kryeqyteti** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete etj.), pra të cilat nuk kanë nevojë të përllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukurore ekzistojnë. Këtu përfshihen edhe grante apo subvencionime të planifikuara për fusha të caktuara dhe për banoret dhe banorët në të gjithë diversitetin e tyre dhe vit pas viti do maten se sa kanë përfituar gratë, të rejtat dhe vajzat në veçanti.
- **4,704 EUR, kosto që mbulohet nga donatorë** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PLVBGJ-së).
- **3,275 EUR (ose 0.04% e totalit të buxhetit të tri viteve) janë hendek financiar**, për të cilat komuna do të llojë për gjetjen e burimeve financiare, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në KAB-et e ardhshme, duke filluar nga KAB 2025 - 2027.

Objektivat strategjikë	Objektivat specifikë	Gjithsej kosto për dy vjet	Kryeqyteti	Donatorë të konfirmuar	Hendek financiar
1. Promovimi i barazisë gjinore dhe	1.1. Rritja e vetëdijesimit të grave, të rejave e	27,618 EUR	25,601 EUR	1,936 EUR	81 EUR

fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.	vajzave të Kryeqytetit, në të gjithë diversitetin e tyre, mbi të drejtat dhe mundësitë e barabarta në çdo fushë.				
	1.2. Zbatimi në praktikë i integritit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si mjete për përparimin e Kryeqytetit drejt barazisë gjinore.	6,943 EUR	3,200 EUR	1,968 EUR	1,775 EUR
Gjithsej Objektiv i strategjik 1:		34,561 EUR	28,801 EUR	3,904 EUR	1,856 EUR
2. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.	2.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve dhe produkteve financiare dhe burimeve produktive, me fokus zhvillimin ekonomik në zonat rurale dhe ekonominë mjedisore.	1,710,214 EUR	1,710,190 EUR	0 EUR	24 EUR
	2.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.	930,000 EUR	930,000 EUR	0 EUR	0 EUR
Gjithsej objektivi strategjik 2:		2,640,214 EUR	2,640,190 EUR	0 EUR	24 EUR
3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre	3.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Kryeqytetit, në të gjithë diversitetin e tyre.	876,396 EUR	875,100 EUR	0 EUR	1,296 EUR

	3.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në kulturë dhe sport.	3,606,000 EUR	3,606,000 EUR	0 EUR	0 EUR
Gjithsej Objektiv strategjik 3:		4,482,396 EUR	4,481,100 EUR	0 EUR	1,296 EUR
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.	4.1. Avancimi i barazisë gjinore me anë të gjithëpërfshirjes në promovim, kujdes dhe edukim shëndetësor, si dhe për shëndetin seksual e riprodhues.	359,989 EUR	359,090 EUR	800 EUR	99 EUR
Gjithsej objektivi strategjik 4:		359,989 EUR	359,090 EUR	800 EUR	99 EUR

Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek Matrica e Planit lokal të veprimit në vijim.

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria/zyra/njësia përgjegjëse për zbatimin e aktivitetit tek *Zyra e Kryetarit të Kryeqytetit*.

Menjëherë pas miratimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2026, si hap i parë i zbatimit të tij, do të mblidhen të dhënat për vlerën bazë të treguesve në nivel të objektivave specifike. Po kështu, do të hartohen edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike. *Raportimet në bazë të objektivave specifike* do të përgatiten *dy herë në vit (çdo 6 muaj)* ose në bazë të kërkesës së Zyrës së Kryetarit.

Monitorimi i zbatimit të Planit vendor të veprimit *në nivel të objektivave* do të kryhet nga **Komiteti për Barazi Gjinore**. Raportet monitorimit (të përgatitura me të dhëna të ndara sipas seksit, etnisë, aftësisë së kufizuar dhe karakteristikave të tjera individuale) do të publikohen në faqen e internetit të Kryeqytetit, do të përcillen edhe tek Grupi joformal i grave asambleiste, si dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Agjencinë për Barazi Gjinore, apo në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Bazuar në monitorimin e kryer, PLVBGJ *duhet të rishikohet dhe përmirësohet* në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	1. PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE, TË REJAVE DHE VAJZAVE NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.							
Rezultatet e pritshme:	1.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e Kryeqytetit për përmbushjen e angazhimit publik zyrtar për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm; 1.b. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen publike të Kryeqytetit, e përmirësuar; 1.c. Strategjitë ose planet e ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Kryeqytetit, me perspektivën gjinore të integruar.							
Referenca në dokumentet kryesore:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 05/L – 020, për barazi gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12; - Programi i Kosovës për barazinë gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivi specifik 1.2, objektivi strategjik 3, objektivat specifike 3.1 dhe 3.2; - Plani i zbatimit në nivel vendi për Kosovën i Planit të veprimit të BE-së për barazinë gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 1, objektivat specifike 3.2 dhe 3.7, fusha tematike 4, objektivat specifike 4.1, 4.2 dhe 4.4; - Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 7; - Konventa e KE për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6; - Deklarata dhe platforma për veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 7, 8 dhe 9; - Agjenda 2030, Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, target 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.a dhe 5.c, treguesit 5.1.1, 5.2.1; 5.2.2, 5.3.1, 5.4.1, 5.5.1, 5.5.2, 5.a.1, 5.a.2 dhe 5.c.1; SDG 16, target 16.7 dhe 16.b, treguesit 16.7.1, 16.7.2 dhe 16.b.1; - Plani i veprimit për barazinë gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 4; - Karta evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale, nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10. 							
Objektivi specifik:	1.1. Rritja e vetëdijesimit të grave, të rejave e vajzave të Kryeqytetit, në të gjithë diversitetin e tyre, mbi të drejtat dhe mundësitë e barabarta në çdo fushë.							
Treguesi		Vlera bazë (2025)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati				
1.1.a. Përqindja e grave, të rejave e vajzave të Kryeqytetit e vetëdijesuar mbi të drejtat e tyre të barabarta si dhe rëndësinë e ofrimit të mundësive dhe angazhimit të barabartë për të gjitha/gjithë.		Do të përcaktohet.	Rritur me 2%	Gratë, të rejtat e vajzat e Kryeqytetit janë më të vetëdijesuara për të drejtat e tyre të barabarta, si dhe për rëndësinë e ofrimit të mundësive dhe angazhimit të barabartë për të gjitha/ gjithë.				
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)		BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ institucionet mbështetëse		2025	2026			

<p>1.1.1. Aktivitete vetëdijësuese në kuadër të javës së 8 Marsit, mbi angazhimin e barabartë të vajzave, të rejave e grave në profesione të ndryshme, veçanërisht në ato profesione që sfidojnë stereotipet gjinore.</p>	<p>Zyrtare e larte për barazi gjinore (ZLBGJ)</p>	<p>Zyra e Kryetarit (ZK). Drejtoria e Arsimit (DA). OJQ Organizatat ndërkombëtar e⁵³ (ON)</p>	<p>2025 – 2026</p>	<p>5,000 € (komuna)</p>	<p>5,000 € (komuna)</p>	<p>ZK Donatorët</p>	<p>- 4 aktiviteteve vetëdijësuese të realizuara (2 çdo vit). - 100 persona të përfshirë (50 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, etj.</p>	<p>Komiteti për Barazi Gjinore në nivel të Kuvendit komunal (KBGJ)</p>
<p>1.1.2. Aktivitete vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë, me fokus të drejtat pronësore të grave.</p>	<p>ZLBGJ</p>	<p>Drejtoria e Kadastrit OJQ ON</p>	<p>2025 – 2026</p>	<p>1,000 € (Kryeqyteti)</p>	<p>1,000 € (Kryeqyteti)</p>	<p>ZK Donatorët</p>	<p>- 2 aktivitete vetëdijësuese të realizuara (1 çdo vit). - 70 pjesëmarrëse/pjesëmarrës (35 në vit), ndarë sipas gjinisë, moshës, etj.</p>	<p>KBGJ</p>
<p>1.1.3. Aktivitete vetëdijësuese kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me fokus vajzat, të rejtat dhe gratë, në të gjithë diversitetin e tyre.</p>	<p>ZLBGJ</p>	<p>ZK Drejtoria e Arsimit (DA) OJQ ON</p>	<p>2025 – 2026</p>	<p>6,500 € ((Kryeqyteti)</p>	<p>6,500 € (Kryeqyteti)</p>	<p>ZK Donatorët</p>	<p>- 2 fushata një mujore vetëdijësuese (1 çdo vit). - Numri i pjesëmarrësve/pjesëmarrësve, ndarë sipas gjinisë, moshës, etj.</p>	<p>KBGJ</p>

⁵³ Me mbështetjen e OSBE

1.1.4. Aktiviteteve vetëdijësuese me nxënës të dhe nxënësit e shkollave të Kryeqytetit, për informimin e tyre mbi të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave.	DA	MASHTI (Sektori për të drejtat e njeriut). QPS. Policia e Kosovës. OJQ ON	2025 – 2026	12,500 € ⁵⁴ (Kryeqyteti)	12,500 € ⁵⁵ (Kryeqyteti)	DA Donatorët.	- Numri i aktiviteteve vetëdijësuese të realizuara çdo vit (nga një aktivitet, në të gjitha shkollat e kryeqytetit, çdo vit) - Numri i pjesëmarrësve/ pjesëmarrësve, ndarë sipas gjinisë, moshës, etj. (Në secilën nga shkollat marrin pjesë rreth 50-60 nxënës/e)	KBGJ
1.1.5. Aktivitete vetëdijësuese me të rejtat/të rinjtë dhe gratë/burrat e Kryeqytetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje, si dhe shërbimet ekzistuese në mbrojtje të këtyre formave të dhunës.	ZLBGJ	ZK	2025 – 2026	6,500 € ⁵⁶ (Kryeqyteti)	6,500 € (Kryeqyteti)	ZK	- Numri i aktiviteteve vetëdijësuese të realizuara çdo vit në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të aktivizmit.	KBGJ

⁵⁴ Kosto për këtë aktivitet e parashikuar në Planin e Veprimit për Siguri në Shkolla 2023 – 2026 dhe nuk ka nevojë të rillogaritet si kosto për zbatimin e këtij Plani Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore

⁵⁵ Kosto për këtë aktivitet e parashikuar në Planin e Veprimit për Siguri në Shkolla 2023 – 2026 dhe nuk ka nevojë të rillogaritet si kosto për zbatimin e këtij Plani Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore

⁵⁶ Kosto e parashikuar në Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2023 – 2025 dhe nuk ka nevojë të rillogaritet si kosto për zbatimin e këtij Plani Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore

							- Numri i pjesëmarrëseve/ pjesëmarrësve, ndarë sipas gjinisë, moshës, etj.	
1.1.6. Sesione informuese/ trajnuese me vajzat/djemtë dhe të rejtat/të rinjtë, për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.	ZLBGJ	Asambleja Komunale e Fëmijëve	2025 - 2026	1,000 € ⁵⁷ (Kryeqyteti)	1,000 € (Kryeqyteti)	ZK	- 4 sesione informuese/ trajnuese të realizuara (2 çdo vit). - 80 pjesëmarrëse/ pjesëmarrës (40 në vit) ndarë sipas gjinisë, moshës, etj.	KBGJ
1.1.7. Aktivitete informuese / vetëdijësuese me prindërit (nëna dhe baballarë) për parandalimin e martesave të hershme të fëmijëve vajza dhe djem.	DA	Qendra për Punë Sociale (QPS) ZKK OJQ ON	2025 - 2026	191 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti dhe 41 € hendek financiar)	191 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti dhe 41 € hendek financiar)	DA Donatorët	- 2 aktivitete të zhvilluara (1 çdo vit). - 50 pjesëmarrëse/ pjesëmarrës (25 në vit) ndarë sipas gjinisë, moshës, etj.	KBGJ
1.1.8. Trajnime për leadership për pozita vendimmarrëse në nivel lokal	Zyra e burimeve njerëzore	Drejtoritë e Kryeqytetit ZKDNJ	2025 - 2026	1,118 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti)	1,118 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti)	Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)	- 2 trajnime të realizuara (1 në vit)	KBGJ

⁵⁷Kosto e parashikuar në Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2023 – 2025 dhe nuk ka nevojë të rillojaritet si kosto për zbatimin e këtij Plani Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore

	Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)	OJQ ON		dhe 968 € donatorët)	dhe 968 € donatorët)	Donatorët	- 50 pjesëmarrëse / pjesëmarrës (25 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	
--	---	-----------	--	----------------------	----------------------	-----------	--	--

Objektivi specifik:		1.2. Zbatimi në praktikë i integritit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si mjete për përparimin e Kryeqytetit drejt barazisë gjinore.						
Treguesi		Vlera bazë (2025)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati				
1.2.a. Përqindja e buxhetit të Kryeqytetit dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.		20,000 €	Rritur me 1%	Planifikimi buxhetor vjetor dhe trevjeçar bazohet në parimet e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe buxheti i dedikuar në mënyrë të veçantë për veprime që synojnë zbatimin e angazhimit zyrtar publik për barazinë gjinore, rritet çdo vit.				
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)		BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2025	2026			
1.2.1. Fuqizimi i kapaciteteve të zyrtareve/zyrtarëve të drejtorive në strukturën e Kryeqytetit, për integrimin gjinor, vlerësimin e ndikimit gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.	ZLBGJ	ABGJ Drejtoria e Administratës OJQ ON	2025 - 2026	1,118 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti dhe 968 € donatorët)	1,118 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti dhe 968 € hendek financiar)	ZK Donatorë ⁵⁸	- 2 trajnime të zhvilluara. - 50 persona të përfshirë (25 në vit) ndarë sipas	KBGJ

⁵⁸Për zbatimin e këtij aktiviteti do të japë mbështetje edhe UN Women

							seksit, pozitës së punës etj.	
1.2.2. Aplikimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) nga të gjitha drejtoritë e Komunës, si dhe publikimi i aneksit mbi Buxhetimin Gjinor në mënyrë të përvitshme.	Drejtoritë komunale	Drejtoria e Financave (DF) OJQ ON	2025 - 2026	900 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti dhe 750 € donatorët)	900 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti dhe 750 € hendek financiar)	Drejtoritë komunale Donatorët ⁵⁹	- Numri i programeve buxhetore ku aplikohet BPGJ	KBGJ
1.2.3. Takime informuese dhe trajnuese me gra / të reja / vajza, në të gjithë diversitetin e tyre, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjimet publike në përgjithësi, e veçanërisht në dëgjimet buxhetore.	Të gjitha drejtoritë komunale që organizojnë dëgjime publike	ZK DF ZKDNJ OJQ ON	2025 - 2026	279 € (nga të cilat 250 € Kryeqyteti dhe 29 € hendek financiar)	279 € (nga të cilat 250 € Kryeqyteti dhe 29 € hendek financiar)	Të gjitha drejtoritë komunale Donatorët	- 2 takime të zhvilluara (1 në vit). - 30 persona të përfshirë ndarë sipas moshës, vendbanimit, etj.	KBGJ
1.2.4. Plotësim-ndryshimi i formave të unifikuara për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit dhe karakteristikave të tjera, për të gjitha aktivitetet që organizon Kryeqyteti.	ZK ZLBGJ	Të gjitha drejtoritë dhe njësitë e Komunës, sipas aktiviteteve që zbatojnë.	2025	425 € (nga të cilat 175 € Kryeqyteti dhe 250 € donatorët)	/	ZK Donatorët ⁶⁰	- Format e përgatitura - Të dhënat që mbledhen të ndara, bazuar në plotësimin e tyre.	KBGJ
1.2.5. Mbledhja e të dhënave bazë për të gjithë treguesit në nivel objektivi specifik, të përcaktuar për matjen e progresit të këtij Plani lokal të veprimtimit për barazinë gjinore (PLVBGJ)	Drejtoritë përgjegjëse sipas aktiviteteve në çdo	ZKDNJ	2025	175 € (Kryeqyteti)	/	Drejtoritë përgjegjëse sipas aktiviteteve në çdo objektivi specifik	- Tabela me të dhëna të plotësuara të vlerës bazë për secilin tregues	KBGJ

⁵⁹Për zbatimin e këtij aktiviteti do të japë mbështetje edhe UN Women

⁶⁰Me mbështetjen edhe të UN Women

	objektiv specifik						të objektivave specifike	
1.2.6. Mbledhja e të dhënave për përgatitjen e raportit dhe publikimi i gjetjeve nga monitorimi i përvitshëm i zbatimit të këtij Plani lokal të veprimit për barazinë gjinore (PLVBGJ)	Drejtoritë përgjegjëse sipas aktiviteteve në çdo objektiv specifik	Të gjitha drejtoritë ZKDNJ OJQ ON	2025 - 2026	875 € (Kryeqyteti)	875 € (Kryeqyteti)	Drejtoritë përgjegjëse Donatorë	- Gjetjet e publikuara në mënyrë të përvitshme, bazuar në raportin e plotë të monitorimit të zbatimit të PLVBGJ.	KBGJ

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	2. PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, SI DHE FUQIZIMI I VAJZAVE, TË REJAVE DHE GRAVE.
Rezultatet e pritshme:	2.a. Praktika e Kryeqytetit për t'u krijuar grave dhe të dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, mundësi për ndërmarrësi dhe punë të denjë, nëpërmjet krijimit të lehtësirave fiskale dhe mbështetjes me mjete monetare, e përmirësuar ndjeshëm; 2.b. Më shumë qasje në shërbime sociale cilësore të përgjegjshme gjinore për gratë, burrat, të rinjtë, vajzat e djemtë e Kryeqytetit.
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji nr. 05/L -020, për barazi gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12, 15, 16, 17 dhe 18; - Programi i Kosovës për barazinë gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivat specifike 1.1 dhe 1.2; - Plani i zbatimit në nivel vendi për Kosovën i Planit të veprimit të BE-së për barazinë gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 3, objektivi specifikë 2, 3, 4, 5 dhe 6; - Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5, 11, 13 dhe 14; - Konventa e KE për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6. - Deklarata dhe Platforma për veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 1 dhe 6; - Agjenda 2030, Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, targets 5.1, 5.4 dhe 5.a, treguesit, 5.1.1, 5.4.1 dhe 5.a.1, SDG 8, targets 8.5 dhe 8.6, treguesit 8.5.2 dhe 8.6.1; - Plani i veprimit për barazinë gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 3; - Karta evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale, nenet 10, 11, 15, 18, 27, 31, 34 dhe 35.

Objektivi specifik:		2.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve dhe produkteve financiare dhe burimeve produktive, me fokus zhvillimin ekonomik në zonat rurale dhe ekonominë mjedisore.⁶¹						
Treguesi		Vlera bazë (2025)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati				
2.1.a. Përqindja e buxhetit të Kryeqytetit dedikuar për subvencione në sektorin e bujqësisë.		1,110,000 €	Rritur me 2%	Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave dhe të rejave veçanërisht nga zonat rurale, në ndërmarrësi. Zhvillimi i ekonomisë mjedisore dhe fuqizimi ekonomik i grave e të rejave. Përmirësimi i kushteve për punësim të denjë e qasje në burime financiare për gratë dhe të rejtat fermere.				
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)		BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ institucionet mbështetëse		2025	2026			
2.1.1. Përfshirja e perspektivës gjinore në promovimin e produkteve bujqësore përmes ngjarjeve, panairove dhe shkëmbimit të përvojave për fermeret dhe fermerët.	Drejtoria e Bujqësisë (DB)	Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP) OJQ të specializuara. ON	2025 - 2026	35,000 € (Kryeqyteti)	35,000 € (Kryeqyteti)	DB Donatorët	- Numri dhe përqindja e fermerëve gra dhe fermerëve burra që marrin pjesë në panairove dhe aktivitete të shkëmbimit të përvojave. - Numri i standeve të drejtuara nga	KBGJ

⁶¹ Aktivitetet dhe treguesit e përcaktuar në këtë objektivi specifik bazohen edhe në gjetjet nga analiza gjinore e Drejtorisë së Bujqësisë me mbështetjen e UN Women, në kuadër të Programit Rajonal: "Financimi transformues për Barazinë Gjinore drejt një Qeverisjeje më Transparente, Gjithëpërfshirëse dhe Llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga SIDA dhe i zbatuar në Kosovë prej vitit 2020.

							gra dhe burra në panaire. Përfitimet ekonomike: ndryshimet në të ardhurat e fermerëve gra dhe fermerëve burra pas pjesëmarrjes në panaire.	
2.1.2. Takime informuese për gratë dhe të rejtat fermere, si dhe për gratë që udhëheqin biznese, mbi mundësitë e përfitimit nga programet e Drejtorisë së Bujqësisë.	DB.	Drejtoria e Administratës Komunale. OJQ. ON	2025 - 2026	107 € (nga të cilat 95 € Kryeqyteti dhe 12 € hendek financiar)	107 € (nga të cilat 95 € Kryeqyteti dhe 12 € hendek financiar)	DB	- 10 takime të zhvilluara (5 në vit). - 10 persona të përfshirë (5 në vit), ndarë sipas zonës, llojit të angazhimit, biznesit etj.	KBGJ
2.1.3. Përfshirja e perspektivës gjinore në rritjen e sipërfaqeve bujqësore me kultivimin e bimëve mjekësore aromatike (BMA).	DB	ON OJQ	2025 - 2026	800,000 € ⁶² (Kryeqyteti)	800,000 € ⁶³ (Kryeqyteti)	DB	- Numri i grave dhe të rejtave fermere të cilat kultivojnë BMA, krahasuar me	KBGJ

⁶² Kosto e përgjithshme për subvencione në vit. Sa do të shpenzohen për këtë aktivitet do përllogaritet në fund të çdo viti.

⁶³ Kosto e përgjithshme për subvencione në vit. Sa do të shpenzohen për këtë aktivitet do përllogaritet në fund të çdo viti.

		Partnerë e bashkëpunëtorë të tjerë.					numrin e përgjithshëm të fermerëve (dhe ndarë sipas llojit të bimëve që kultivojnë).	
2.1.4. Ofrimi i mundësisë së promovimit dhe shitjes së produkteve bujqësore, me fokus mbështetjen e grave e të rejave fermere, përmes organizimit të Tregut mobil të fermereve / fermerëve.	DB	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.	2025 - 2026	20,000 € (Kryeqyteti)	20,000 € (Kryeqyteti)	DB	- Numri i grave dhe të rejave fermere që marrin pjesë në Tregun mobil. - Numri i shesheve që përdoren për tregun mobil.	KBGJ
2.1.5. Përmirësimi i kushteve të punës për fermeret/ fermerët përmes subvencionimit të mekanizmit bujqësor, ku në kushte të barabarta përparësi në bazë të thirrjes për aplikim dhe poentimit, do të kenë gratë dhe të rejtat fermere.	DB	Organizata ndërkombëtare . OJQ. Partnerë e bashkëpunëtorë të ndryshëm.	2025 - 2026 (Gjatë vitit.)	Kosto e përfshirë në koston e aktivitetit 2.1.3 më sipër	Kosto e përfshirë në koston e aktivitetit 2.1.3 më sipër	DB	- Numri i fermereve (gra dhe të reja) që i përmirësojnë kushtet e punës nëpërmjet subvencionimit të mekanizmit bujqësor.	KBGJ
2.1.7. Ofrimi i kushteve më të favorshme në prodhimtari bimore, rritja e sipërfaqeve me ambiente të mbrojtura, të cilat paraqesin formën intensive të prodhimtarisë së kulturave bujqësore (ndërtimin e serave), ku në kushte të barabarta, përparësi në bazë	DB	Organizata ndërkombëtare . OJQ. Partnerë e bashkëpunëtorë të ndryshëm.	2025 - 2026 (Gjatë vitit.)	Kosto e përfshirë në koston e aktivitetit 2.1.3 më sipër	Kosto e përfshirë në koston e aktivitetit 2.1.3 më sipër	DB	- Numri i serrave të ndërtuara që menaxhohen nga gratë / të rejtat	KBGJ

të thirrjes për aplikim dhe poentimit, do të kenë gratë dhe të rejat fermere.								
Objektivi specifik:	2.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.							
Treguesi	Vlera bazë (2025)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati					
2.2.a. Përqindja e grupeve të cënueshme të përfshira në shërbime sociale dhe rezidenciale, me fokus janë gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre.	Do përcaktohet	Rritur me 1%	Gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre kanë më shumë qasje në shërbime sociale cilësore dhe janë më të mbrojtura nga përjashtimi social. Plotësimi i gamës së shërbimeve sociale cilësore, do të sjellë edhe një rritje të të kuptuarit të rolit të grave dhe burrave në familje, për rrjedhojë do të synohet në riorganizimin dhe diskutimin për ndarjen e barabartë të punës shtëpiake dhe kujdesit në familje, ndërmjet të gjitha/gjithë anëtareve/anëtarëve të saj.					
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)		BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2025	2026			
2.2.1. Integrimi i perspektivës gjinore në ndarjen e subvencioneve për familjet në asistencë sociale (nënat vetushqyese, familjet me një anëtar/e, personat me aftësi të kufizuara, personat që kanë pësuar dhunë, etj.)	Drejtoria e Mirëqenies Sociale (DMS).	Drejtoria e Financës. Qendra për Punë Sociale. Zyra e Kryetarit.	2025 - 2026	400,000 € (Kryeqyteti)	400,000 € (Kryeqyteti)	DMS	- Numri i përfitueseve/përfituesve ⁶⁴ , ndarë sipas gjinisë, moshës dhe klasifikimit të familjeve në	Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ)

⁶⁴ Si individë përfitues të Skemave Sociale, 100-150 €, për periudhën janar – shtator 2023 rezultojnë 517 përfituese/përfitues dhe 722 përfituese/përfitues gjithsej në vitin 2022. Si individë përfitues persona me aftësi të kufizuara, 150 € rezultojnë 792 përfituese/përfitues për vitin 2022 dhe 792 përfituese/përfitues për periudhën janar- shtator 2023.

		Kuvendi komunal.					asistencë sociale.	
2.2.2. Ofrimi i ndihmës së njehershme ⁶⁵ për përballimin e kostos për fëmijët e paslindur për nënat lehona të skemës sociale.	DMS	Drejtoria e Financës. Qendra për Punë Sociale. Zyra e Kryetarit. Kuvendi komunal.	2025 - 2026	E përlogaritur brenda zërit në aktivitetin 2.2.1.	E përlogaritur brenda zërit në aktivitetin 2.2.1.	DMS	- Numri i nënave lehona të mbështetura në vit.	KBGJ
2.2.3. Ofrimi i strehimit social ⁶⁶ për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje	DMS	Zyra e Kryetarit. OJQ “Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve”. Kuvendi komunal.	2025 - 2026	60,000 € ⁶⁷	60,000 € ⁶⁸	DMS	- Numri i viktimave/të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje të strehuara, ndarë sipas moshës, seksit, e karakteristika ve të tjera.	KBGJ

⁶⁵ Shuma për nënën lehona të Skemës Sociale, për sigurimin e produkteve esenciale për të porsalindurin, është në vlerën 500 €. Për vitin 2022 janë mbështetur 35 nëna dhe për periudhën janar – shtator 2023 janë mbështetur 28 nëna lehona.

⁶⁶ Një viktimë / e mbijetuar e dhunës në familje mbështetet me një pagesë prej 100-500 € në muaj, për strehim dhe ushqim, për një periudhë deri në 2 vjet. 21 gra e të reja kanë përfituar mbështetje për strehim, për periudhën janar-dhjetor 2023.

⁶⁷ Kosto e paraparë në Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2023 – 2025.

⁶⁸ Kosto e paraparë në Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2023 – 2025.

2.2.4. Subvencione për përmirësimin e cilësisë dhe përgjegjshmërisë gjinore të shërbimeve sociale e familjare, përmes nën kontraktimit të OJQ-ve të specializuara.	DMS	Drejtoria e Financës. Qendra për Punë Sociale. Zyra e Kryetarit. Kuvendi Komunal.	2025 - 2026	E përlogaritur brenda zërit në aktivitetin 2.2.1.	E përlogaritur brenda zërit në aktivitetin 2.2.1.	DMS	- Numri i OJQ-ve të licencuara, të kontraktuara për ofrimin e shërbimeve sociale cilësore e të përgjegjshme gjinore.	KBGJ
2.2.5. Avokimi për ndërtimin e shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve vajza dhe djem në situatë emergjente, te Shtëpia për persona të moshuar pa përkujdesje familjare.	DMS	Ministria e Punës dhe Transferave. Ministria e Shëndetësisë. Ministria e Ambientit. ON	2025 - 2026	50,000 € (Kryeqyteti)	80,000 € (Kryeqyteti)	DMS	- Fillimi i punës për ndërtimin e shërbimit të identifikuar. - Sigurimi i fondit në vijim për ndërtimin e shërbimit.	KBGJ

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	3. ZVOGËLIMI I PABARAZIVE GJINORE NË ARSIM CILËSOR, KULTURË E SPORT, PËR GRATË, BURRAT, TË REJAT, TË RINJTË, VAJZAT DHE DJEMTË, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE
Rezultatet e pritshme:	3.a. Qasja e grave, të rejave dhe vajzave, si dhe djemve, të rinjve e burrave, në të gjithë diversitetin e tyre, në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, e përmirësuar ndjeshëm. 3.b. Më shumë vajza të reja dhe gra të Kryeqytetit, të angazhuara në aktivitete sportive e kulturore.
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji nr. 05/L -020 për barazi gjinore, nenet 2, 4, 5, 6, 12, 20 dhe 18; - Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 2, objektivat specifike 2.1 dhe 2.2; - Plani i zbatimit në nivel vendi për Kosovën i Planit të veprimit të BE-së për barazinë gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 3, objektivi specifikë 2, 3, 4, 5 dhe 6;

	<ul style="list-style-type: none"> - Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 10; - Konventa e KE-së për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6; - Deklarata dhe platforma për veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 2; - Agjenda 2030, Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 4, target 4.2, 4.3, 4.4, 4.5, 4.7 dhe 4.5, treguesit 4.2.1, 4.3.1, 4.4.1, 4.7.1 dhe 4.a.1; SDG 5, target 5.1 dhe 5.c, treguesit 5.1.1 dhe 5.c.1; - Plani i veprimit për barazinë gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 3; - Karta evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale, nenet 10, 13, 16, 20, 24, 31, 34 dhe 35. 							
Objektivi specifik:	3.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Kryeqytetit, në të gjithë diversitetin e tyre.							
Treguesi	Vlera bazë (2025)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati					
3.1.a. Numri i studenteve vajza të Kryeqytetit që përfitojnë bursa.	75 vajza përfituan bursë për vitin 2023	Numri i studenteve vajza që përfitojnë bursa për të studiuar në SHTIM, rritur me 2%	Do të sfidohen stereotipet gjinore në arsim, duke u krijuar kushtet e nevojshme për qasje të barabartë në arsim cilësor për të gjitha / gjithë vajzat, djemtë, të rejat, të rinjtë, gratë dhe burrat në Kryeqytet. Do nxiten më shumë vajzat e të rejat të orientohen në studimet për SHTIM.					
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)		BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2025	2026			
3.1.1. Organizimi i fushatës “Dyert e hapura”, ku nxënëset dhe nxënësit mund të informohen rreth profileve që mund të përcaktohen, duke synuar edhe thyerjen e stereotipeve gjinore në punësim.	DA	ZLBGJ Shkollat.	2025 - 2026	31,175 € (Kryeqyteti)	31,175 € (Kryeqyteti)	DA	- Fushata e zhvilluar sipas planifikimit. - Numri i nxënësve/ nxënësve të	KBGJ

							përfshirë ⁶⁹ , ndarë sipas gjinisë, moshës dhe karakteristika ve të tjera.	
3.1.2. Ndarja e bursave komunale për studentet dhe studentët e Kryeqytetit të Prishtinës.	DA	Drejtoria e Financave. ZK	2025 - 2026	40,000 € (Kryeqyteti)	40,000 € (Kryeqyteti)	DA	- Numri i bursave të ndara çdo vit ⁷⁰ , sipas gjinisë, moshës, degës së zgjedhur, etj.	KBGJ
3.1.3. Fuqizimi i kapaciteteve të mësimdhënësve / mësimdhënësve në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.	DA	OJQ	2025 - 2026	798 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti dhe 648 € hendek financiar)	798 € (nga të cilat 150 € Kryeqyteti dhe 648 € hendek financiar)	DA	- 70 mësimdhënës /e të trajnuar/a (35 në vit), ndarë sipas seksit, profilit,	KBGJ

⁶⁹ Në këtë aktivitet që zgjat më së paku 14 ditë, marrin pjesë të gjitha/gjithë nxënëset dhe nxënësit e klasave të nënta.

⁷⁰ 120 bursa të ndara për vitin 2024 (88 për studente vajza dhe 32 për studentë djem), me përfituese/përfitues nga të gjitha profilet e fakulteteve të UP-së: Fakulteti i Arteve- 4 studente vajza; Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës – 8 studente vajza; Fakulteti i Mjekësisë- 10 studente vajza; Fakulteti i Edukimit – 14 studente vajza; Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike – 2 studente vajza; Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - 6 studente vajza; Fakulteti Juridik – 6 studente vajza; Fakulteti Filologjik – 8 studente vajza; Fakulteti i Shkencave Matematiko -Natyrore - 11 studente vajza; Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit – 1 studente vajzë; Fakulteti Ekonomik – 4 studente vajza; Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës - 9 studente vajza.

							moshës, temës së trajnimit, etj.	
3.1.4. Sesione informuese për tematika të lidhura me bulizmin, diskriminimin gjinor dhe disavantazhimin e shumëfishtë.	DA	OJQ	2025 - 2026	500 € (Kryeqyteti)	500 € (Kryeqyteti)	DA	2 sesione (1 në vit) - duke specifikuar edhe pjesëmarrjen e nxënësve/ nxënësve	KBGJ
3.1.5. Ngritje e shkathtësive digjitale me mentorim e trajnim për çdo mësimdhënëse/ mësimdhënës.	DA	Sektori i IT-së Zyra e Kryetarit OJQ ON	2025 - 2026	100 € (Kryeqyteti)	100 € (Kryeqyteti)	DA Donatorët	- Numri i institucioneve arsimore të furnizuara me tabela digjitale ⁷¹ . -70 mësimdhënës /e të trajnuar/a, ndarë sipas seksit, moshës, etj. (35 çdo vit)	KBGJ
3.1.6. Vlerësimi pedagogjik i nxënësve/nxënësve me nevoja të veçanta nga Ekipi komunal pedagogjik përkatës	DA	Ekipi Komunal Pedagogjik	2025 - 2026	5,625 € (Kryeqyteti)	5,625 € (Kryeqyteti)	ZK	- 150 nxënës/e të vlerësuar/a për vitin 2024. Numri	KBGJ

⁷¹ DA gjatë qershorit 2024 ka furnizuar disa institucione me tabela digjitale ku njëkohësisht është ofruar edhe trajnimi i mësimdhënëseve / mësimdhënës për përdorimin e tyre.

							ndryshon në varësi të kërkesës.	
3.1.7 Subvencionimi i fëmijëve (vajza e djem) në kopshtet me bazë në komunitet dhe partneritetin publik – privat (PPP), si mundësi për lehtësimin e qasjes së nënave në tregun e punës.	DA	Drejtoria e Financave. ZK Kuvendi komunal.	2025 - 2026	240,000 € (Kryeqyteti)	240,000 € (Kryeqyteti)	DA	- 433 fëmijë të subvencionuar në kopshtet me bazë në komunitet (193 vajza dhe 243 djem)	KBGJ
3.1.8. Subvencionimi i fëmijëve (vajza dhe djem) në kopshtet private, të licencuara (me vlerë 70 Euro), nëse prindërit e fëmijëve i kanë të ardhurat nën 500 €, si mundësi për lehtësimin e qasjes së nënave tregun e punës.	Drejtoria e Arsimit.	Drejtoria e Financave. Zyra e Kryetarit. Kuvendi komunal.	2025 - 2026 (Gjatë gjithë vitit.)	120,000 € (Kryeqyteti)	120,000 € (Kryeqyteti)	Drejtoria e Arsimit	- Numri i fëmijëve ⁷² të subvencionuar në kopshtet private, ndarë sipas seksit, moshës dhe karakteristika ve të tjera.	Komiteti për Barazi Gjinore

Objektivi specifik:	3.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në kulturë dhe sport.		
Treguesi	Vlera bazë (2025)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati
3.2.a. Përqindja e grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, fituese për “subvencionet në kulturë” dhe subvencionet në sport”.	40%	Rritur me 2%	Do të sfidohen stereotipet gjinore në kulturë dhe sport, duke u krijuar kushtet e nevojshme për qasje të barabartë për të gjitha / gjithë vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat në Kryeqytet.

⁷²Në periudhën nëntor 2023 –qershor 2024 janë subvencionuar 131 fëmijë prej tyre 67 vajza dhe 64 djem.

AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)		BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2025	2026			
3.2.1. Përfshirja e perspektivës gjinore në organizimin e ngjarjeve kulturore dhe artistike, si dhe parandalimi i stereotipave gjinore në projektet në Kulturë dhe art.	Drejtoria e Kulturës (DK)	Drejtoria e Financës. ZK OJQ. Biznese private. Individë.	2025	500,000 € ⁷³	/	DK	- 70 vajza, të reja dhe gra përfitojnë subvencion në kulturë	KBGJ Komiteti për Kulturë dhe Sport (KKS)
3.2.2. Mbështetje vjetore e aktiviteteve të klubeve sportive dhe OJQ rinore.	Drejtoria e Sporteve (DS)	DF ZK Klubet Sportive.	2025 - 2026	803,000 € ⁷⁴	803,000 € ⁷⁵	DS	- 21 projekte të OJQ të drejuara nga gratë. 165 përfituese/ përfitues në vit.	KBGJ KKS
3.2.3. Organizimi i aktivitetit të përvitshëm “laureatet/laureatët e vitit” duke siguruar qasje të barabartë gjinore.	DS	DF ZK	2025 - 2026	E përlogaritur brenda zërit 3.2.2. më sipër ⁷⁶	E përlogaritur brenda zërit 3.2.2. më sipër	DS	165 klube dhe OJQ të mbështetura.	KBGJ KKS

⁷³ Kosto totale për subvencione në kulturë për të gjithë vitin. Sa % do të shkojë për vajzat, të reja dhe gratë, do të llogaritet në fund të çdo viti.

⁷⁴ Kosto totale për subvencione në sport për të gjithë vitin. Sa % do të shkojë për vajzat, të reja dhe gratë, do të llogaritet në fund të çdo viti.

⁷⁵ Kosto totale për subvencione në sport për të gjithë vitin. Sa % do të shkojë për vajzat, të reja dhe gratë, do të llogaritet në fund të çdo viti.

⁷⁶ Nga kjo shumë mbështeten edhe laureatet/laureatët e vitit rreth me rreth 15,000 euro çmime, ku barazia gjinore është 50 përqind.

		Klubet Sportive.					- mbi 40 çmime të ndara për sport, ku barazia gjinore është 50 përqind. - 20 bursa, 10 për vajza 10 për djem sportiste dhe sportistë	
3.2.4. Përfshirja e perspektivës gjinore në panaire dhe aktivitete të ndryshme kulturore e sportive.	DK	DF ZK OJQ. Biznese private. Individë.	2025 - 2026	E përlogaritur brenda zërit 3.2.1. më sipër	E përlogaritur brenda zërit 3.2.1. më sipër	DK	- 5 panaire të mbështetura në vit. - 10 gra e të reja pjesëmarrëse	KBGJ KKS
3.2.5. Sigurimi i zhveshtoreve për vajzat në të gjitha ambientet sportive	DS	DF Klubet Sportive.	2025 - 2026	750,000€ (investime kapitale)	750,000€ (investime kapitale)	DS	- Një zhveshtore, tre tribuna	KBGJ KKS
3.2.6. Subvencionimi i klubeve të vajzave dhe avokimi në mënyrë të vazhdueshme për mbështetjen e këtyre klubeve	DS	Klubet sportive OJQ ON	2025 - 2026	E përlogaritur brenda zërit 3.2.1. më sipër	E përlogaritur brenda zërit 3.2.1. më sipër	DS	- Ligat për vajzat aplikohen njëloj sikurse ekzistojë për djemtë	KBGJ KKS

							Drejtoria e Sportit propozon që stadiumi në fshatin Bardhosh të shfrytëzohet nga Klubi i futbollit të vajzave.	
--	--	--	--	--	--	--	--	--

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	4. PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE SEKSUALE DHE RIPRODHUESE.
Rezultatet e pritshme:	4.a. Edukimit mbi shëndetin seksual e riprodhues të personelit arsimor dhe nxënëseve e nxënësve në shkollat e mesme profesionale të Kryeqytetit, i jepet vëmendje; 4.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm;
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji nr. 05/L -020, për barazi gjinore, nenet 2,4, 5, 6, 11 dhe 12; - Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 2, objektivi specifik 2.3; - Plani i zbatimit në nivel vendi për Kosovën i Planit të veprimit të BE-së për barazinë gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 2, objektivat specifike 2.1 dhe 2.2; - Konventa për eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 12; - Konventa e KE-së për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6; - Deklarata dhe platforma për veprim e Pekinit (BDPfA), fusha kritike 3; - Agjenda 2030, Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 3, target 3.7 dhe 3.8, treguesit 3.7.1 dhe 3.8.1; SDG 5, target 5.6, treguesi 5.6.1; - Plani i veprimit për barazinë gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fushat tematike 2 dhe 3; - Karta evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale, nenet 6, 10, 14, 34 dhe 37.
Objektivi specifik:	4.1. Avancimi i barazisë gjinore me anë të gjithpërfshirjes në promovim, kujdes dhe edukim shëndetësor, si dhe për shëndetin seksual e riprodhues.

Treguesi		Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati				
4.1.a. Numri i nxënësve/ nxënësve dhe mësimdhënësve / mësimdhënësve të përfshirë në aktivitete edukuese mbi shëndetin dhe të drejtat seksuale e riprodhuese		Do përcaktohet gjatë vitit 2025	Rritur me 3%	Do të sfidohen stereotipet gjinore në lidhje me diskutimin mbi shëndetin seksual e riprodhues dhe do të krijohen më shumë mundësi për vajzat, të rejtat e gratë që të marrin vendimmarrje të informuara mbi trupin dhe shëndetin seksual të tyre.				
4.1.b. Numri i nxënësve/ nxënësve dhe mësimdhënësve / mësimdhënësve të përfshirë në aktivitete edukuese për menaxhimin e higjienës menstruale.								
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)		BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2025	2026			
4.1.1. Takime koordinuese me personelin shëndetësor dhe Drejtorinë e Shëndetësisë për organizimin e aktiviteteve vetëdijësuese në shkollat e Kryeqytetit	Drejtoria e Shëndetit (DSH)	QKMF. Anëtarë nga MKKDHF. Drejtoria e Arsimit. Shkollat.	2025 - 2026	268 € (nga të cilat 250 € Kryeqyteti dhe 18 € hendek financiar)	268 € (nga të cilat 250 € Kryeqyteti dhe 18 € hendek financiar)	DSH	- 2 takime të organizuara (1 në vit)	Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ)
4.1.2. Përzgjedhja e temave mbi edukimin dhe promovimin për shëndetin seksual e riprodhues, si dhe përgatitja e materialit për takimet vetëdijësuese (fokus të veçantë në këto tema do marrë menaxhimi i higjienës menstruale)	QKMF	Anëtarë nga MKKDHF.	2025 - 2026	377 € (Kryeqyteti)	377 € (Kryeqyteti)	DSH	- Materiali i përgatitur dhe i gatshëm në version elektronik.	KBGJ
4.1.3. Realizimi i aktiviteteve vetëdijësuese në mënyrë	QKMF.	Anëtarë nga MKKDHF.	2025 -	782 €	782 €	DSH	- 12 aktiviteteve të	KBGJ

interaktive me shkollat e përzgjedhura	Menaxhment shkollë i përzgjedhur		2026	(nga të cilat 750 € Kryeqyteti dhe 32 € hendek financiar)	(nga të cilat 750 € Kryeqyteti dhe 32 € hendek financiar)		realizuara (6 çdo vit) - 240 nxënese / nxënës (120 çdo vit) ndarë sipas seksit, moshës e karakteristika ve të tjera.	
4.1.4. Aktivitete vetëdijësuese përgjatë muajit tetor – Sensibilizimi mbi kancerin e gjirit	DSH	QKMF.	2025 - 2026	3,568 € (nga të cilat 3,168 € Kryeqyteti dhe 400 € donator)	3,568 € (nga të cilat 3,168 € Kryeqyteti dhe 400 € donator)	DSH Donatorë	- Numri i aktiviteteve të zhvilluara - Numri i grave/të rejave të informuara	KBGJ
4.1.5. Ndarja e subvencioneve / mbështetjes për gratë e prekura dhe të mbijetuara nga kanceri i gjirit	DSH	QKMF	2025 - 2026	350,000 € ⁷⁷ (Kryeqyteti)	Varion nga viti në vit	DSH	- Rreth 650 kërkesa çdo vit	KBGJ

⁷⁷ Të gjitha subvencionet në fushën e shëndetësisë për të gjithë vitin. Sa përqind shkon për subvencione për gratë me sëmundjen e kancerit të gjirit, do llogaritet në fund të çdo viti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**) e Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më, merr këtë

V E N D I M
P Ë R
FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS
SË KUVENDIT PËR VITIN 2025

1. Miratohet Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2025.

2. Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit,
2. , anëtar,
3. , anëtar,
4. , anëtar,
5. , anëtar,
6. , anëtar,
7. , përfaqësues i ekzekutivit, anëtar,
8. , përfaqësues i Zyrës ligjore, anëtar,
9. , përfaqësues i Sektorit për punë të Kuvendit, anëtar.

3. Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera - pjesën me kompetencë të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2025. Pas hartimit të planit final, grupi punues do ta prezantojë para Kuvendit të Kryeqytetit për miratim.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



RAPORTI VJETOR I KUVENDIT TË KRYEQYTETIT
JANAR – DHJETOR 2024

Hyrje

Kuvendi i Kryeqytetit funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale dhe Statutit të Komunës së Prishtinës.

Nëpërmjet këtij raporti, paraqesim një analizë të të gjitha arritjeve, sfidave, gjatë periudhës, që fillon nga data 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024.

Ky raport përfshinë të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe.

Raporti vjetor janar-dhjetor 2024, përmban: informata rreth mbledhjeve të rregullta, të jashtëzakonshme dhe solemne të mbajtura në Kuvendin e Kryeqytetit, informata nga mbledhjet e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera, listen e akteve të miratuara dhe informata për mbarvajtjen e mbledhjeve.

Kuvendi i Kryeqytetit gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2024, gjithsej ka mbajtur 9 (nëntë), mbledhje të rregullta, 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje të jashtëzakonshme dhe 6 (gjashtë) mbledhje solemne.

Gjatë këtij viti në mbledhjet e Kuvendit të Kryeqytetit kemi pasur raste të lëshimit apo bojkotimit të mbledhjeve nga grupet parlamentare:

- Në mbledhjen e parë të Kuvendit të Kryeqytetit më 31.1.2024, në mungesë të kuorumit mbledhja është anuluar;
- Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit mbajtur më 8.2.2024, është lëshuar mbledhja nga një grup parlamentar, por mbledhja ka vazhduar;
- Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit mbajtur më 27.2.2024, është bojkotuar mbledhja nga një grup parlamentar, por mbledhja ka vazhduar;
- Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit mbajtur më 14.3.2024, është bojkotuar mbledhja nga një grup parlamentar, por mbledhja ka vazhduar;
- Në mbledhjen e dytë të Kuvendit mbajtur më 8.5.2024, është lëshuar mbledhja nga një grup parlamentar, por mbledhja ka vazhduar;
- Në mbledhjen e pestë të Kuvendit mbajtur më 27.6.2024, është lëshuar mbledhja nga një grup parlamentar dhe në mungesë të kuorumit mbyllet mbledhja;
- Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit mbajtur më 18.9.2024, është lëshuar mbledhja nga një grup parlamentar dhe në mungesë të kuorumit mbyllet mbledhja;
- Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit mbajtur më 30.9.2024, një grup parlamentar ka bojkotuar mbledhjen ndërsa një grup tjetër ka lëshuar mbledhjen dhe në mungesë të kuorumit mbyllet mbledhja;
- Në mbledhjen e nëntë të Kuvendit, e mbajtur më 13.11.2024, është mbyllur mbledhja në mungesë të kuorumit.

Për periudhën janar – dhjetor 2024, Kuvendi i Kryeqytetit gjithsej ka miratuar 47 (dyzet e shtatë) vendime, të ndara nëpër mbledhje:

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 8.2.2024.

1. Vendim për anulimin e Vendimit nr. 01-020/04-236518/23, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 21.12.2023.

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 27.2.2024.

1. Vendim për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 14.3.2024.

1. Vendim për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.

Mbledhja e parë e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 24.4.2024.

1. Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Vendim për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara;
3. Vendim për zyrtarizimin e emërimit të parkut memorial në oborrin e bibliotekës kombëtare “Të zhdukurit me dhunë nga Serbia”;
4. Anulimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, dt. 16.6.2010, të dt. 5.9.2023;
5. Vendim për marrëveshje - kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunksional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës-Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë-Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit;
6. Vendim për nismën e Kryetarit të Kryeqytetit për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal;
7. Vendim për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projektregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe nbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, dt. 16.6.2010;
8. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, Sinani dhe Selmani;
9. Vendim për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve tjera;
10. Vendim për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

11.Vendim për vazhdimin e kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës Sociale Edukative “Don Bosko”, Prishtinë.

Mbledhja e dytë e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 8.5.2024.

- 1.Vendim për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera pas vërshimeve të mëdha që kanë ndodhur në komunën e Prishtinës në vitin 2023;
- 2.Vendim për formimin e komisionit për verifikimin e ngjarjeve të ndodhura në mbledhjen e jashtëzakonshme, të dt. 14.3.2024.

Mbledhja e tretë e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 24.5.2024.

- 1.Vendim për vënien në konsultim publik të projektregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;
- 2.Vendim për paradhënie lidhur me shpërblimin e dëmit për znj. Elza Ujkani.

Mbledhja e jashtëzakonshme, mbajtur më 3.6.2024.

1. **Vendim** për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria” 2024-2032, në Prishtinë.

Mbledhja e katërt e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 13.6.2024.

1. Vendim për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me emrin e humanistit dr. Gani Demolli;
2. Vendim për rritjen dhe bartjen e mjeteve nga tejkalimi i Planit për të hyra vetjake nga viti 2023 në vitin 2024;
- 3.Vendim për transferimin e mjeteve;
4. Vendim për formimin e Forumit për transparencë komunale në Komunën e Prishtinës.

Mbledhja e pestë e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 27.6.2024.

1. Vendim për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024;
2. Vendim për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2025-2027.

Mbledhja e gjashtë e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 29.7.2024.

1. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë për menaxhimin e deponive në Kosovë (KMDK) SHA;
2. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare “3X3 Prishtina”;
3. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare KH “Prishtina”;
4. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare KB “Sigal Prishtina”;
5. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare KV “Prishtina”;
6. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për “Federatën e Hendbollit të Kosovës”;
7. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për “Klubin e Futsallit Prishtina 01 – FCF. Prishtina”;
- 01”;
8. Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për KBF “Prishtina”.

Mbledhja e shtatë e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 13.9.2024.

1. Vendim për shkarkimin e antarëve të komisionit të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve”;
2. Vendim për emërimin e antarëve të komisionit të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve”;
3. Vendim për emërimin e antarëve të komisionit të aksionarëve të NPL “Trafiku Urban”;
4. Vendim për shfuqizimin e paragrafit 3, të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, 01-030/01-227581/23, të dt. 1.12.2023;
5. Vendim për ndarjen e mjeteve NPL “Kuzhina Qendrore” SHA në Prishtinë.

Mbledhja e tetë të Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 14. 10. 2024.

1. Vendim për vënien në diskutim publik për ndryshim–plotsimin e Rregullores së menaxhimit të mbeturinave;
2. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
3. Vendim për vënien në diskutim publik të Projektplanit lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026;
4. Vendim për vënien në diskutim publik të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë.

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 5.12.2024.

1. Vendim për shfuqizimin e Vendimit, nr. 01-060/01-123059/24, dt. 18.9.2024, lidhur me paragrafin 3 të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.
2. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, nr. 01-030/01-227581/23, dt. 1.12.2023.

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 9.12.2024.

1. Vendim për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025.

Mbledhja e nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 13.12.2024.

1. Vendimi për kompensim vjetor financiar të punonjësve të administratës së Komunës së Prishtinës;
2. Vendimi për vënien në diskutim publik të Rregullores për kompensim ditor për financimin e ushqimit për punonjësit e Komunës së Prishtinës.

Të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Kryeqytetit janë të publikuara në ueb-faqet zyrtare të Komunës dhe janë të publikuara në të dy gjuhët.

Komiteti për Politikë dhe Financa, gjatë kësaj periudhe ka mbajtur gjithsejtë 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje, si dhe Komiteti për Komunitete po ashtu ka mbajtur 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje të rregullta.

Gjatë vitit 2024, Kuvendi i Kryeqytetit nuk ka themeluar komitete të tjera.

Komitetet tjera të formuara më herët kanë mbajtur gjithsej:

- Komiteti për Arsim, dy mbledhje;
- Komiteti për Shërbime Publike, një mbledhje;
- Komiteti për Planifikim strategjik, urbanizëm dhe mbrojtje të ambientit, një mbledhje.

Kryetari i Kryeqytetit gjatë kësaj periudhe ka raportuar në Kuvendin e Kryeqytetit:

Mbledhja e dytë e Kuvendit të Kryeqytetit, e mbajtur më 8.5.2024:

Raport i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2023.

Ligji për vetëqeverisjen lokale, përkatësisht neni 68 i tij përcakton se komuna mban dy takime publike, njëri në gjashtëmujorin e parë, ku ceket data e takimit.

Diskutim i përgjithshëm me qytetarë, mbajturë më 25.6.2024, si dhe diskutim i përgjithshëm me qytetarë, mbajtur më 23.12.2024.

Kryeqyteti-Prishtina ka mbajtur edhe diskutime të tjera publike:

Diskutim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kalabria” në Prishtinë, mbajtur më 22.2.2024 - 7.3.2024.

Diskutim publik lidhur me Planifikimin e buxhetit për vitin 2025, të mbajtura më 29.7.2024 deri më 2.8.2024;

Diskutim publik për raportin për Lejen mjedisore komunale për ndërtimin e Parkut të Aventurave, mbajtur më 19.9.2024;

Diskutim publik lidhur më Rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, mbajtur më 30.10.2024;

Diskutim publik lidhur me Planin për barazi gjinore 2024-2026 nga Komuna e Prishtinës, mbajtur më 4.11.2024;

Diskutim publik lidhur me Statutin e QKMF-së në Komunën e Prishtinës, mbajtur më 19.11.2024.

Në Planin vjetor të punës së Kuvendit për periudhën prill-dhjetor 2024, janë paraparë gjithsej 71 (shtatëdhjetë e një) pika të rendit të ditës.

Në bazë të këtij raporti shihet se diku rreth 70% e këtij plani vjetor është i realizuar.

Të gjitha të dhënat më të detajuara për informatat mbi këtë raport i gjeni në ueb-faqet zyrtare të Komunës së Prishtinës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d), nenit 17, pika o), dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika i) të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 24 të Ligjit nr. 04/L-071, për sistemin e adresave (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 29/27, dhjetor 2011) të Udhëzimit administrativ nr. 16/2019, për krijimin e listës alfabetike për emërtime të listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2025, merr këtë

V E N D I M

1. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, nr. 01-020/05-69249/23, dt. 3.4.2023.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, ndryshim – plotësimi nënkupton zëvendësimin e anëtarëve
3. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01-020/05-69249/23, dt. 3.4.2023, mbesin të pandryshuara.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 01-020/04-215599/23 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, të dt. 03.11.2023.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit dhe drejtoritë e tjera relevante.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

PROPOZIM

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d) dhe nenit 17, pika k) e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, nenit 14, paragrafi 6 dhe nenit 29, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-084, për mbrojtjen e fëmijës, nenit 22, paragrafët 1 dhe 8 të Ligjit nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare, si dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë:

V E N D I M

PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR FAMILJET STREHUESE DHE FËMIJËT NË STREHIM FAMILJAR

Neni 1 **Qëllimi**

1. Miratohet Vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar.
2. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i ndihmës financiare për përkujdesjen dhe mbështetjen e ofruar nga familjet strehuese për fëmijët.

Neni 2 **Komponentët e ndihmës**

1. Subvencionimi i familjeve strehuese, në shumë prej 200 euro në muaj.
2. Subvencionimi i fëmijëve në strehim familjar në shumë prej 200 euro në muaj për fëmijë.

3. Subvencionimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar në strehim familjar në shumë prej 250 euro në muaj për fëmijë.

4. Subvencionimi i familjeve strehuese në gatishmëri për strehim të fëmijëve në shumë 150 euro në muaj.

5. Subvencionimi i personave që arrijnë moshën 18 vjeç, që nuk kanë zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë, e që janë në strehim familjar, mbështetet me 450 euro në muaj.

Neni 3

Procedura për përkrahje

1. Procedura për përkrahje financiare iniciohet nga menaxheri i rastit në Qendrën për Punë Sociale (QPS) në Prishtinë.

2. QPS bashkëpunon me organet relevante për të vlerësuar dhe aprovuar përfitimin e ndihmës financiare.

Neni 4

Afatet dhe monitorimi

1. Kjo ndihmë financiare mund të ofrohet për një periudhë deri në 12 muaj, me mundësi vazhdimi sipas vlerësimeve të QPS.

2. Monitorimi i zbatimit të këtij vendimi bëhet nga QPS dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe organet tjera relevante.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15, paragrafi 5 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më _____, merr këtë:

V E N D I M PËR SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT TË NXËNËSVE

1. **Miratohet** Subvencionimi i transportit të nxënësve nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, subvencionimi do të vlejë për nxënësit e nivelit parafillor dhe fillor, në rastet kur numri i nxënësve është nga një (1) deri katër (4) nxënës, të cilët udhëtojnë mbi 4 km në një drejtim, atyre që jetojnë në vise rurale dhe zona urbane ku ka rrezik të lartë dhe nuk mund të organizohet transporti nga Drejtoria e Arsimit.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, subvencionimi i transportit të nxënësve do të bëhet në vlerë prej 192.00 euro në muaj dhe vetëm për periudhat kohore sipas kalendarit vjetor të organizimit të procesit mësimor.
4. Subvencionimi i nxënësve do të bëhet në bazë të kërkesave nga institucionet arsimore dhe shqyrtimin sipas kriterëve do ta bëjë një komision i themeluar nga Kryetari i kryeqytetit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i kryeqytetit, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb – faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), neneve 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, nenit 32, pika **c** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .2025, merr këtë:

V E N D I M
PËR VËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

- 1. Miratohet** Vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për: “Strategjia e Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031”.
- Organizimi i konsultimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023, për administratë të hapur në komuna.
- Sipas pikës 1 të këtij vendimi, konsultimi publik zgjat jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtje të konsultimeve.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, respektivisht zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik dhe Drejtoria e Kulturës.
- Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina**

PROJEKTRREGULLORE

PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NGA KOMUNA E PRISHTINËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c) e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, 4 qershor 2008), nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe në zbatim të nenit 36, paragrafi 3 i Rregullës financiare, nr. 01/2013 - MF - Shpenzimi i parave publike, dhe në bazë të nenit 52, pika h) dhe nenit 33, paragrafi 33.1, pika a) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më __.__.__, miratoi këtë

RREGULLORE

PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NGA KOMUNA E PRISHTINËS

KAPITULLI I
Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës së Prishtinës të ndajë mjete financiare pa kthim, nga kategoria e subvencioneve, në fushat e cekura, për persona fizikë dhe juridikë.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga organet komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit, si persona fizikë dhe juridikë.

Neni 2 **Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim si në vazhdim:

Subvencionet - në kuptim të kësaj rregullore, subvencionet përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik.

Pagesa e pakthyeshme - është e njëanshme, atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.

Përfituesi - nënkupton personat fizikë dhe juridikë që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.

Ndërmarrje publike lokale - nënkupton ndërmarrje publike lokale në pronësi të Komunës së Prishtinës ose në të cilën Komuna e Prishtinës ka aksione.

Banor rezident - nënkupton personi që jeton dhe vepron në komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Raporti narrativ - nënkupton të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit, të cilat duhet të dorëzohen nga përfituesi i subvencionit.

Raporti financiar - nënkupton që përfituesi i subvencionit t'i dorëzojë të gjitha dëshmitë për shpenzimet financiare, ashtu siç janë kërkuar në projektpropozim.

Krijimi i veprës së re - nënkupton stimulimin e krijuesve përmes mbështetjes financiare për krijimtari të veprave të reja vizuale-figurative, si p.sh. pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn, mozaik, mural, performancë, vepër multiaplikative etj.

Rezidenca artistike - nënkupton stimulimin e bashkëpunimit të organizatave joqeveritare kulturore me krijues dhe veprimtarë të huaj kulturorë (kuratorë dhe menaxherë kulturorë), të cilët ftohen për qëndrim në komunën e Prishtinës. Rezidencat kulturore mund të jenë në fushat: art vizual, literaturë, muzikë, teatër, si dhe shumë disiplinore.

Kompozimi i veprës së re muzikore - nënkupton stimulimin e krijuesve përmes mbështetjes financiare për krijimtari të re. Vepra e re muzikore mund të jetë solistike, ansamble kamertale, vokale, apo vokalo-instrumentale.

Audio-incizim - nënkupton stimulimin e prodhimit të audio-incizimeve të muzikës klasike: xhaz, rok dhe alternative. Mbështetje jepet për incizim në studio dhe masterim.

Neni 3

Limitet buxhetore

1. Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal, për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.
2. Komuna ndan subvencione për këto fusha: arsim, zhvillim ekonomik, bujqësi, shëndetësi, mirëqenie sociale, barazi gjinore, kulturë, rini dhe sport, siguri, ndërmarrje publike lokale, digjitalizim, promovim, si dhe duke mos u kufizuar edhe në fusha tjera.
3. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të që kalojnë shumë prej 500 €, bëhet në bazë të Rregullores MF-nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Ndarja e subvencioneve sipas kësaj rregulloreje do të zbatohet për të gjitha rastet, ashtu siç është paraparë në nenin 2, pika 5 të Rregullores MF-nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 4

Subjektet përfituese të subvencioneve

Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizikë, OJQ-të dhe në raste të veçanta, personat juridik që ndërlidhen me ndonjë aktivitet nga fushat e përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo, në raste të veçanta, në bazë të kërkesës së arsyetuar, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës, përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata të tjera me rëndësi. Këto procedura zhvillohen në pajtim me Rregulloren MF-nr-04/2017, si dhe me dispozitat e parapara të kësaj rregulloreje.

3. Ndarja e subvencioneve sipas kërkesave të veçanta, aplikohet për kategorinë e subvencioneve të cilat i ndan Kryetari i Kryeqytetit, në të gjitha fushat e përcaktuara me këtë rregullore.

3.1. Subjektet përfituese sipas paragrafit 2 të këtij neni, për të njëjtin projekt nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Kryetarit sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 6

Përfashtimet nga ndarja e subvencioneve

1. Përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizikë jo rezident të komunës së Prishtinës.

2. Asnjë subjekt nuk mund të jetë përfitues i subvencioneve, nëse paraprakisht nuk e ka mbyllur subvencionin paraprak në pajtim me kushtet e përcaktuara në kontratën për ndarjen e subvencioneve.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Themelimi, përbërja, kohëzgjatja dhe mandati i komisioneve për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve përmes thirrjes publike, bëhet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e Rregullores MF-nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Themelimi, përbërja, kohëzgjatja dhe mandati i Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të veçanta për ndarje të subvencioneve të Kryetarit të Kryeqytetit, bëhet si në vijim:

2.1. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, tre (3) anëtarë përfaqësues nga Komuna dhe dy (2) anëtarë ekspertë të jashtëm nga Shoqëria civile. Kryesuesi i këtij Komisioni duhet të jetë nëpunës civil nga Komuna e Prishtinës.

2.2. Komisioni do të ketë dy (2) anëtarë zëvendësues (një nëpunës civil nga Komuna dhe një nga Shoqëria civile), të cilët në rastet e caktuara e zëvendësojnë anëtarin e rregullt në rast të mungesës së tij, apo anëtarin i cili ka deklaruar konflikt të interesit.

2.3. Mandati i Komisionit sipas paragrafit 2 të këtij neni, është një (1) vjeçar, me mundësi të vazhdimit.

2.4. Komisioni duhet të ketë përfaqësim të balancuar gjinor.

3. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, veprojnë në pajtim me ligjin, këtë Rregullore dhe konform autorizimeve që jepen nga Kryetari i Komunës.

4. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.

5. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e subvencioneve, duhet të deklarojnë paraprakisht mundësinë e ekzistencës së interesit të tyre privat lidhur me vendimmarrjen në raste të caktuara, që mund të jenë shkak për lindjen e konfliktit të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues dhe vendimmarrja

1. Detyrat, përgjegjësitë, procedura e vlerësimit dhe e vendimmarrjes së komisioneve vlerësuese për ndarjen e subvencioneve sipas thirrjes publike, si dhe ato sipas kërkesave të veçanta, bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 16 të Rregullores MF 04/2017.

2. Komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, brenda afatit prej 45 ditëve pas përfundimit të afatit të shpalljes publike, dhe vepron në pajtim me legjislacionin për financat publike, dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionin në fuqi.

3. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit.

4. Komisioni mban procesverbal gjatë mbledhjeve, i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.

5. Brenda 5 ditëve të punës, pas marrjes së vendimit nga Komisioni, lista e përfituesve të subvencioneve, e cila publikohet në ueb-faqen zyrtare, si dhe në tabelën e shpalljeve publike të Komunës. !!!

6. Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së përfituesve, Komisioni në afat prej 15 ditëve, pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin e subvencionit, i paraqet raport me shkrim Kryetarit të Kryeqytetit, i cili e prezanton mbarëvajtjen e procesit.

Neni 9

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat dy (2) vjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve.
2. Komisioni do të jetë në përbërje prej tre (3) anëtarëve. Kryetari dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, duhet të jenë shërbyes civilë, një anëtar duhet të jetë zyrtar ligjor, si dhe duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
3. Komisioni mban procesverbale të mbledhjeve të mbajtura, të cilët duhet të nënshkruhen nga anëtarët e Komisionit.
4. Anëtarë të Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.

Neni 10

Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

1. Ankesa parashtrohet në afat prej 5 ditë pune pas njoftimit të vendimit preliminar të Komisionit vlerësues për mos përfshirje në publikimin e listës preliminare të përfituesve të subvencioneve.
2. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 10 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave.
3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave gjatë vendimmarrjes, vepron në bazë të ligjit për procedurën administrative dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
4. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

5. Brenda afatit prej tre (3) ditë pune pas vendimmarrjes se Komisionit për shqyrtimin e ankesave, bëhet publikimi i listës përfundimtare të përfituesve të subvencioneve të fushës përkatëse.

Neni 11

Zbatimi i vendimit

1. Vendimi i Komisionit vlerësues për ndarjen e subvencioneve bëhet i zbatueshëm, nëse:

- 1.1. nuk është paraqitur ankesë, sipas kësaj rregulloreje, ose
- 1.2. refuzohet ankesa me vendimin e komisionit të ankesave.
- 1.3. Përfshihen në listën përfundimtare subjektet të cilave iu aprovohet ankesa si e bazuar.

Neni 12

Shpallja publike për ndarje të subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores MF 04/2017.

2. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret e përgjithshme të cilat dalin nga kjo Rregullore, Rregullorja MF 04/2017, si dhe kriteret specifike të fushës përkatëse të cilat përcaktohen nga drejtoria përkatëse e Kryeqytetit, varësisht prej specifikave dhe programeve të përcaktuara për subvencionim.

3. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes.

Neni 13

Kontrata për subvencionim

1. Për realizimin e subvencioneve duhet të lidhet kontratë, me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet në mes të Komunës dhe përfituesit të subvencionit.

2. Kontrata duhet t'i përcaktojë subjektet nënshkruese të kontratës, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, monitorimin, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi, si dhe pjesë të tjera relevante për kontratën.

3. Kontrata duhet të nënshkruhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, pas shpalljes së vendimit për ndarje të subvencioneve.

Neni 14

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) bursa për studentë;
- b) bursa për nxënës të shkollave të mesme;
- c) bursa për nxënës të shkollave fillore;
- d) kuadro deficitarë;
- e) nxënës me nevoja të veçanta;
- f) gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore);
- g) botimin e librave/revistave;
- h) nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- i) mësimdhënës që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Subvencionet për pikat: a), b) dhe c) të këtij neni ndahen sipas thirrjes publike, ndërsa subvencionet për pikat: d), e), f), g), h) dhe i) të këtij neni, ndahen sipas kërkesave të arsyetuara të paraqitura nga institucionet arsimore, arsimtarët, nxënësit, studentët, prindërit, si dhe nga të gjitha institucionet dhe organizatat tjera që kanë për qëllim ngritjen arsimore - edukative.

3. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me thirrjen publike sipas drejtorisë përkatëse dhe të miratuara nga Kryetari i Kryeqytetit.

4. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës, nëse brenda vitit të njëjtë kalendarik ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga niveli qendror.

5. Përfituesit e subvencioneve sipas këtij neni, duhet të jenë banorë të komunës së Prishtinës.

Neni 15

Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Subvencionet për fushën e zhvillimit ekonomik dhe rural ndahen për të promovuar zhvillimin e bizneseve individuale dhe të vogla.

2. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) zeje bashkëkohore dhe tradicionale;
- b) agrobiznes;
- c) teknologji informative;
- d) ndërmarrje publike;
- e) biznes inovativ;
- f) ndërmarrje sociale;
- g) aktivitetet e shoqatave që ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin;
- h) inkubatorët e biznesit;
- i) bizneset e reja ose fillestare;
- j) aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit;
- k) aktivitetet për hulumtime të tregut;
- l) Inkurajimi i punësimit të qëndrueshëm të gjinisë së nën përfaqësuar në këtë sektor.

3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në komunën e Prishtinës.

4. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe të ATK-së.

Neni 16

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike, si në vijim:

- a) bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;
- b) grave, të rinjve, veprimtarive në zona rurale, personave me nevoja të veçanta dhe minoriteteve etnike;
- c) bizneseve të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale;
- d) OJQ-ve të cilët aplikojnë me projekte biznesi, që mundësojnë gjenerim të vendeve të punës;
- e) bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga Komuna dhe gjatë vitit të njëjtë kalendarik, nuk kanë qenë përfitues të një subvencioni për zhvillim ekonomik, të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

2. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga

ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal, në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 17 **Subvencionet për bujqësi**

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:
 - a) projekte të fermerëve, shoqatave bujqësore, kooperativave bujqësore, fushat bujqësore me prioritet për Komunën;
 - b) organizimin e panairëve, seminareve, vizitave studimore;
 - c) mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;
 - d) projekte në sektorin e pylltarisë;
 - e) përkrahja për zhvillim dhe turizëm rural.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi:
 - a) zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;
 - b) pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim me 20% të vlerës, me përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;
 - c) grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe minoriteteve etnike;
 - d) aplikuesve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga Komuna dhe gjatë vitit të njëjtë kalendarik nuk kanë qenë përfitues të ndonjë subvencionit për bujqësi, të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

3. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 18 **Subvencionet në lëmin e shëndetësisë**

1. Komuna ndan subvencione për qytetarët të cilët janë rezidentë, për përballimin e shpenzimeve të shërimit apo mjekimit, sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Shëndetësisë.

2. Subvencionet për shëndetësi jepen në vijim, por duke mos u kufizuar vetëm në:

- a) sëmundjet malinje;
- b) sëmundjet e rënda kronike, të shoqëruara edhe me çrregullime të sistemeve tjera;
- c) sëmundjet, terapia e së cilave nuk janë të përfshira në listë esenciale;
- d) terapia pas ndërhyrjeve kirurgjike me kohëzgjatje mbi 12 muaj;
- e) lehonat - problemet e shfaqura gjatë kësaj periudhe.

3. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 19

Subvencionet në lëmin e mirëqenies sociale për individë dhe familje

1. Në rast të varfërisë së skajshme të individit apo familjes, të fatkeqësive natyrore, të familjeve me përkujdesje të fëmijëve me çrregullime të përhershme shëndetësore, me fëmijë dhe persona të moshës madhore, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara dhe që janë banorë të komunës së Prishtinës, Kryetari i Komunës në bazë të kërkesave të arsyetuara, ndan subvencione momentale të njëhershme dhe forma të tjera të mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transferove, sipas ndarjeve të aprovuara me buxhet të Komunës.
2. Të drejtë aplikimi për përfitimin e ndihmës momentale dhe të njëhershme, kanë të gjitha familjet apo individët, pavarësisht a janë apo nuk janë shfrytëzues të Skemës së ndihmës sociale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Kërkesa për ndihmë momentale të njëhershme, e bërë nga individi/familja, dorëzohet në Qendrën për shërbime me qytetarë, në Komunën e Prishtinës.
4. Familjet apo individët, si dhe subjektet juridike jofitimprurëse, për të njëjtën nevojë mund të aplikojnë vetëm një herë brenda vitit kalendarik, përjashtuar rastet e jashtëzakonshme nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, të cilat i konstaton komisioni përkatës nëpërmjet vizitës në terren dhe mund të kërkohet konstatim shtesë i gjendjes socio-ekonomike nga Qendra për Punë Sociale/Njësia përkatëse sipas territorit.

5. Mbështetja financiare dhe ndihma momentale e njehershme nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, përjashtojnë të gjitha pagesat dhe transferet për qëllime kapitale.

6. Këto subvencione janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për individët, familjet dhe institucionet joprofitabile.

7. Kërkesa për ndihmë të njehershme mund të bëhet jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas momentit të ndodhjes së rastit të jashtëzakonshëm.

8. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal, në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 20

Qiraja joprofitabile e subvencionuar për pagesë familjeve apo individëve me gjendje të rëndë sociale që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit

1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës planifikimin buxhetor për pagesën e qirave për familjet apo individët në nevojë përmes miratimit vjetor të buxhetit.
2. Komuna ka të drejtën e pagesës së qirave për familjet apo individët e Komunës së Prishtinës që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, të cilët jo domosdoshmërisht duhet të jenë përfitues të Skemës sociale, për gjendjen e së cilit konstaton komisioni përkatës nëpërmjet vizitës në terren.
3. Numri i familjeve apo individëve përfitues nga kjo kategori, përcaktohet në pajtim me ndarjen buxhetore sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Të drejtën e subvencionimit e kanë banorët, të cilët në komunën e Prishtinës janë rezidentë së paku prej pesë (5) vjetëve.
5. Qiraja e subvencionuar nga buxheti i Komunës nuk mund të kalojë shumën prej treqind (300 €) Euro, për një (1) muaj.

Neni 21

Përcaktimi i kriterëve dhe i radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve apo individëve në gjendje të nevojës, të cilat mund të subvencionohen për pagesën e qirasë

1. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit për personat dhe familjet e paraqitura janë:

- a) statusi i banimit;
- b) lartësia e të ardhurave;
- c) gjendja shëndetësore;
- d) të ketë përjetuar ose përballur kërcënimin e dhunës në familje ;
- e) invaliditeti dhe
- f) struktura e familjes.

2.Për secilin kriter të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij nenin, drejtorja përkatëse për mirëqenie sociale i propozon kriteret specifike, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve për pagesën e qirasë, të cilat do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për çdo vit fiskal.

Neni 22

Përparësitë në përzgjedhjen e familjeve të subvencionuara

1. Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë:

- a) familjet me shumë fëmijë;
- b) familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi të kufizuara;
- c) familjet ku kryefamiljari është grua – mbajtëse e familjes;
- d) bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë,
- e) personat që kanë vuajtur ose janë në rrezik të pësojnë dhunë në familje dhe
- f) fëmijët me statusin e jetimit.

Neni 23

Afati për pagesën e qirasë së banimit

1. Pas aprovimit të propozimeve nga Kryetari i Komunës, drejtori i drejtorisë përkatëse, lidh kontratë me pronarin e banimit ku përfitues është familja apo individ i cili plotëson kriteret sipas kësaj rregulloreje.

2. Pagesa e qirasë së banimit nuk mund të bëhet më tepër se për pesë (5) vjet.

Neni 24

Rastet e ndërprerjes së subvencionit të qirasë apo shkëputjes së kontratës së qirasë

1.Palës përfituese të subvencionimit të qirasë, i ndërpritet e drejta për pagesë apo shkëputja e kontratës së qirasë, kur:

- a) qiramarrësi ka bërë deklaram të rrejshëm për të ardhurat;

- b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk e ka njoftuar organin kompetent të Komunës;
- c) qiramarrësi ia lëshon banesën me qira palës së tretë;
- d) qiramarrësit i përmirësohet gjendja ekonomike, të cilin fakt e vlerëson në baza vjetore Komisioni vlerësues i Komunës;
- e) qiramarrësit i punësohet njëri nga anëtarët e familjes me pagë mbi minimale;
- f) qiramarrësi i kalon pesë (5) vjet nga momenti i lidhjes së kontratës.

Neni 25

1. Komuna ndan subvencione:
 - 1.1. për lehonat, të cilat janë pjesë e Skemës së ndihmës sociale (SNS), i jepet nënave lehona, të cilat lindin fëmijë, janë pjesë e SNS-së dhe janë banorë rezidentë të komunës së Prishtinës;
 - 1.2. për viktimat e dhunës në familje, përfituesit e së cilit mund të aplikojnë për mbështetje në komponentë të caktuar;
 - 1.3. për familjet strehuese, të cilët strehojnë fëmijët dhe të rritur pa përkujdesje prindërore;
 - 1.4. për ngrohje, në varësi të mundësive buxhetore të vitit fiskal, ndan të drejtën për ndarjen e subvencioneve të njëhershme, për ofrimin e ndihmës për furnizim me ngrohje për familjet me skemë të ndihmës sociale.
2. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse.

Neni 26

1. Komuna ndan subvencione për OJQ-të për ofrimin e shërbimeve sociale.
2. Kriteret, dokumentet që nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal në thirrjen publike të shpallur nga drejtoria përkatëse. Kur shërbimet përcaktohen se janë të nevojshme për banorët e komunës, bazuar në analiza, dhe nuk janë të disponueshme ndryshe, Komuna do të lidhë kontrata shumëvjeçare për të parandaluar ndërprerjen e shërbimeve të rëndësishme.

Neni 27 Subvencionet për kulturë, rini, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport, duke përfshirë:

1.1 Fushën e Kulturës

- a) **Art vizual - figurativ:** krijim i veprës së re, fuqizimi i artistëve të rinj, ekspozitë, hulumtim kuratorial, instalime në hapësira publike, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;
- b) **Botime:** për fëmijë, për të rinj, romane, tregime, përkthime, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe hulumtime kulturore;
- c) **Festival:** art figurativ, art në hapësira publike, arkitekturë, ekologji, film, letrar, shumë disiplinor, muzikë, folklor, teatër, teknologji informative, vallëzim etj.;
- d) **Kinematografi:** film dokumentar, film i shkurtër, film i animuar, fuqizimi i kinematografëve të rinj, titrim dhe zhvillim skenari;
- e) **Manifestime:** shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shënimi i datave të tjera me rëndësi në komunën e Prishtinës;
- f) **Mbështetje e aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë:** aktivitete mujore, programe arsimore, fuqizim i krijuesve të rinj, rezidencë artistike, debate, ligjërata dhe hulumtime;
- g) **Muzikë:** kompozim i veprës së re, audio-incizim, koncert, fuqizimi i muzikantëve të rinj, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;
- h) **Organizim:** performancë, trajnim, punëtori, debat, tryezë, ligjërata, simpozium dhe konferencë;
- i) **Shoqëri Kulturo-Artistike:** mbështetje e aktiviteteve vjetore, blerja e kostumeve, blerja e instrumenteve dhe pjesëmarrje në festivale;
- j) **Teatër:** prodhimi i shfaqjes, promovim dhe pjesëmarrje e shfaqjes në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;
- k) **Trashëgimi kulturore:** ciceroni i Prishtinës, fushata vetëdijesimi, pjesëmarrje aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtim i trashëgimisë kulturore në

komunën e Prishtinës, promovimi i diversitetit kulturor në komunën e Prishtinës, turizëm kulturor në komunën e Prishtinës, platforma informative dhe inovacion teknologjik;

l) **Shpërblime vjetore:** vepra më e mirë e vitit, krijuesit e vitit, ngjarja kulturore e vitit, projekti kulturor i vitit dhe operatori kulturor i vitit.

1.2. Fushën e Rinisë

a) **Fuqizimi i organizatave rinore:** mbështetja e aktiviteteve të OJQ-ve, promovimi i vullnetarizmit, integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara, pjesëmarrje në seminare, konferenca etj., brenda dhe jashtë vendit, mbështetja e ideve - projekteve të të rinjve, si dhe promovimi i talenteve të rinj;

b) **Edukimi joformal:** trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, hulumtime, simpoziume, konferenca etj.;

c) **Shpërblime vjetore:** vullnetari i vitit, ngjarja rinore e vitit, projekti rinor i vitit dhe organizata rinore e vitit.

1.3 Fushën e Sportit

a) **Masivizimi i sportit:** masivizimi i sportit për të rinj, avancimi i aktiviteteve në klubet sportive të femrave, integrimi i minoriteteve në aktivitete dhe gara sportive, integrimi i personave me aftësi të kufizuara në aktivitete dhe gara sportive, mbështetje e aktiviteteve sportive për fëmijët e Prishtinës, përkrahja e projekteve me qëllim të zhvillimit të ligave shkollore në nivel lokal dhe rajonal;

b) **Ngritja e kapacitetit në fushën e sportit:** përkrahja e klubeve publike sportive, përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet e suksesshme, bashkëpunimi me organizata të ndryshme sportive, vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të realizimit të projekteve për avancimin e trajnerëve, të cilët punojnë me grup-mosha të ndryshme, ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive, si dhe aktivitete edukative me simpatizantë, me qëllim të evitimit të dhunës dhe kultivimit të vlerave fisnike të sportit;

c) **Organizime:** trajnime, punëtori, debate, tryeza, ligjërata, hulumtime, simpoziume, konferenca, mbështetje të personave me nevoja të veçanta etj.;

d) **Shpërblime vjetore:** sportistët/ laureatët e sportit, shpresa e sportit, ngjarja sportive e vitit, klubi sportiv i vitit dhe individët e inkuadruar në sport si punëtorë profesionalë (trajnerë, gjyqtarë, përzgjedhës, pedagogë, punëtorë sportivë, veteranë të sportit, gazetarë sportivë etj.).

2. Kriteret, dokumentet qe nevojiten për ndarjen e subvencioneve, kategoritë dhe shumat e subvencionimit të parapara me këtë nen, do të përcaktohen me vendim të veçantë nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çdo vit fiskal, në thirrjen publike të shpallur nga drejtoritë përkatëse.

Neni 28 **Shpenzimet për funeral**

Komuna mund të ndajë subvencione për shpenzimet e funeralit për anëtarët e ngushtë të personit të vdekur, deri në shumën e paraparë prej 300 euro.

Neni 29 **Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për mbulimin e shpenzimeve të funeralit**

1. Komuna mund të ndajë subvencione për shpenzimet e funeralit, për qytetarët që janë familjarë të ngushtë të personave që kanë ndërruar jetë, sipas dokumentacionit të cekur si në vijim:

- a) faturën për shërbimet e marra nga ndërmarrja publike lokale "Gjelbër" SHA;
- b) faturën nga bashkësia fetare, përmes së cilës janë kryer ritet fetare për personin e vdekur, në rast se funerali i nënshtrohet ritualeve fetare;
- c) faturën nga kompania përkatëse që është shfrytëzuar për transportimin e kufomës së personit të vdekur.

2. Personat që e shfrytëzojnë të drejtën e përcaktuar si në nenin 28, duhet t'i paraqesin dokumentet si në vijim:

- a) ekstraktin e lindjes së personit që ka ndërruar jetë;
- b) certifikatën e vdekjes së personit familjar;
- c) dokumentin e identifikimit të familjarit të ngushtë, së bashku me numrin e xhirollogarisë bankare.

3. Subvencionimi i së drejtës së paraparë sipas nenit 28, nuk mund të kalojë periudhën kohore prej 90 ditësh, duke llogaritur nga data e vdekjes.

4. E drejta e paraparë sipas nenit 28, shterohet me shfrytëzimin e së njëjtës nga familjari i parë që paraqitet para organeve komunale.

Neni 30
Subvencionet e ndara me vendim të Kuvendit të Kryeqytetit

1. Me vendim të Kuvendit të Kryeqytetit ndahen subvencionet si në vijim:

- a) Subvencionet për ndërmarrjet publike lokale të Kryeqytetit ose në ato ku Kryeqyteti është aksionar;
- b) Subvencionet për Kopshtet e fëmijëve me bazë në komunitet, ose për institucione tjera në të cilat Komuna e Prishtinës ka interes publik;
- c) Subvencionet në fushat e përcaktuara me këtë rregullore, të cilat e kalojnë shumën mbi 20, 000 (20 mijë euro).

2. Propozimet në Kuvend të Kryeqytetit për ndarjen e subvencioneve sipas këtij neni dërgohen nga Kryetari i Kryeqytetit.

Neni 31
Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit, të dorëzojnë në Komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare, ashtu siç janë kërkuar me projekt propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj.

2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve, të dorëzojnë raportin narrativ, i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit, duke përfshirë të dhënat për përfituesit, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë.

3. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë kalendarike pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe Komunës.

4. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni, protokollohen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e Komunës.

Neni 32
Monitorimi i përfitueseve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga Komuna në formë të subvencioneve.

2. Komuna bën monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit, apo marrëveshjes për mjetet e ndara në formë të subvencioneve.
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 të këtij neni, bëhet në periudhën kohore deri në 3 vjet nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 33

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 2 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari.
2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shumat që u janë ndarë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, Komuna nuk i publikon subvencionet për rastet e përcaktuara në nenin 18, paragrafi 2, pikat: a), b), c), neni 21, pika: d), dhe neni 22, pika: e).
4. Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencioneve, bëhet në ueb-faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve, si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e komunës.
5. Komuna do t'i publikojë në ueb faqen e saj raportet nga përfituesit në ueb faqen e saj brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga miratimi i raportit nga Komuna, ku përfshihen emri i përfituesit, rasti, fusha për të cilën jepen subvencionet dhe shumata që janë të ndarë, dhe numrin e përfituesve, të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, moshës dhe aftësisë së kufizuar. Kjo nuk do të zbatohet për subvencionet e dhëna sipas paragrafit 3 të këtij neni, për të cilat vetëm numri i përgjithshëm i përfituesve të ndarë sipas gjinisë dhe etnisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar, do të publikohen si numër total në vit me shumën totale të parashikuar dhe qëllimin e saj.

Neni 34

Dispozitat kalimtare dhe shfuqizuese

1. Ndarja e subvencioneve e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, vazhdon me rregullativën ekzistuese, pavarësisht nëse kjo rregullore hyn në fuqi.

2. Pagesat sipas nenit 29 të kësaj rregulloreje do të aplikohen nga data 1.4.2024. Nëse pas datës 1.4.2024, janë kryer pagesat sipas këtij neni, në shumën e mëparshme të përcaktuar prej 210 euro, atëherë do të paguhet diferenca e pagesës në vlerë prej 90 euro.

3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja nr. 01-020/01-194101/18 e dt. 8.8.2018.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimi në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina